





Praktika të mira të digjitalizimit të mësimdhënies



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:


swisscontact



**PRAKTIKA TË MIRA
TË DIGJITALIZIMIT
TË MËSIMDHËNIES**

“Unë veproj kështu!”

“UNË VEPROJ KËSHTU!”

– PRAKTIKA TË MIRA TË DIGJITALIZIMIT TË MËSIMDHËNIES

Raste të mira 2023

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikëqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Publikimi u përgatit nga Fjorela Pahumi dhe Edlira Kola.

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

AFTËSI PËR PUNË S4J
Rruga Skënderbej, Vila nr. 49
Tirana, Albania, P.O. Box 2891
+355 42 231 850
al.info@swisscontact.org
www.skillsforjobs.al

TABELA E PËRMBAJTJES

Fjalë hapëse Fation Dragoshi, Menaxher i Projektit “Aftësi për Punë”	5
Fjalë hapëse Ejvis Gishti, Drejtor i Përgjithshëm, AKAFPK	6
Parafjalë	7
A. Materialet mësimore digjitale	9
Diversifikimi i përvojës digjitale të nxënësve Julian Kasapi, shkolla e mesme profesionale “Salih Çeka”	12
Materiali mësimor digjital si bazë e orës së mësimi Silvana Bushi, shkolla e mesme profesionale “Hamdi Bushati”	15
B. Diskutimi përmes platformave digjitale si nxitës i angazhimit gjatë dhe përtej orës mësimore	19
Platformat ndërvepruese si mjet për rritjen e angazhimit të nxënësve gjatë orës së mësimi Jonida Haxhi, shkolla teknike elektrike “Gjergj Canco”	22
Komunikimi dhe të nxënësve përtej orës së mësimi: pjesëmarrja asinkrone në forume Ermira Mani, shkolla e mesme profesionale “Hamdi Bushati”	25
C. Realizimi i vlerësimit të nxënësve nëpërmjet platformave digjitale	29
Vlerësimi digjital si instrument motivimi Jurgen Jazaj, shkolla teknike elektrike “Gjergj Canco”	32
Vlerësimi përmblendhës nëpërmjet platformës Alma Koçi, shkolla e mesme profesionale “Ali Myftiu”	35
D. Promovimi i gjithëpërfshirjes dhe aksesibilitetit nëpërmjet materialeve mësimore digjitale	40
Realizimi i një materiali mësimor digjital gjithëpërfshirës Nertila Dundo, shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”	42
Nisma “Sill pajisjen tënde” (Bring Your Own Device) Meralda Mahilaj, shkolla Tregtare Vlorë	44
E. Kapilarizimi i procesit mësimor me bazë teknologjinë	47
Promovimi i mësimi të kombinuar nëpërmjet Digital Focal Points: rasti I shkollës “Kolin Gjoka” Rudina Gjoka, shkolla profesionale “Kolin Gjoka”	50
Aftësimi digjital mes mësuesëve në mbështetje të përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie Dorian Memoçi, shkolla “Teknike Ekonomike” Tiranë	52





Të dashur lexues,

Siç është pranuar tanimë kudo, teknologjia është kthyer në një mjet thelbësor në institucionet arsimore. Metodat dhe materialet tradicionale të mësimdhënies dhe të nxënimit po i lënë vendin mënyrave të reja angazhuese dhe interaktive. Nga platformat te përmbajtja mësimore digjitale, nga transferimi i njohurive te vlerësimi elektronik, nga burimet digjitale te videot apo simulimet interaktive, teknologjia në duart e mësuesve dhe të nxënësve po krijon një përvojë mësimore më të pasur, si dhe mundësi rrugëtimi të personalizuar të të nxënimit.

Falë teknologjive digjitale, ka ndryshuar edhe procesi i mbledhjes dhe i dokumentimit të të dhënave mbi përparimin e nxënësve, duke i ndihmuar mësuesit të identifikojnë më lehtë nevojat e nxënësve dhe të përshtatin metodat e tyre të mësimdhënies. Njëkohësisht, në sajë të digjitalizimit, procesi mësimor po bëhet më gjithëpërfshirës. Mësuesit po arrijnë një audiencë më të gjerë, duke u ardhur pranë edhe individëve që më parë mund të kenë qenë të përjashtuar. Hendeqet e diktuar nga veçoritë socio-demografike apo aftësitë ndryshe, sa vijnë e ngushtohen.

Megjithatë, përqaftimi i teknologjisë në arsim paraqet gjithashtu sfida për mësuesit. Për të përdorur në mënyrë efektive teknologjinë në mësimdhënien e tyre, mësuesit duhet të jenë të gatshëm të mësojnë aftësi të reja, të përshtaten me metodat novatore dhe të jenë të njohur me teknologjinë në dispozicion. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje të përfshijnë teknologjitë digjitale në mësimdhënien e tyre, duke i shtuar vlerë procesit mësimor.

Në këtë botim, nëpërmjet eksperiencës së 10 mësuesve në shkollat tona profesionale, do të eksplorojmë se si mësuesit mund të përdorin në mënyrë efektive teknologjinë për të përmirësuar praktikën e tyre të mësimdhënies si dhe të ndërgjegjësohemi mbi ndikimin që digjitalizimi ka në procesin e mësimdhënies. Shpresojmë që ky publikim t'ju japë një kuptim më të qartë të rëndësisë së integritit të teknologjisë në procesin mësimor e më gjerë, në arsim, me besimin se një qasje e tillë do të përkthehet në mundësi të reja dhe emocionuese të të nxënimit për brezin e ri.

Përzemërsisht i juaji,

Fation Dragoshi

Menaxher Projekti

Projekti “Aftësi për Punë” (S4J)



Të dashur lexues,

Ndërsa hyjmë në një epokë të re të zhvillimit të hovshëm të teknologjisë dhe avancimit të saj nëpërmjet Inteligjencës Artificiale, është e domosdoshme që të përqafojmë revolucionin digjiital dhe ta përdorim atë në avantazhin tonë. Digjitalizimi tashmë ka filluar të ndryshojë mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe mësojmë, dhe arsimiti nuk bën përjashtim. Me disponueshmërinë e platformave për edukim, klasave virtuale dhe mundësinë për të nxënë online, është thelbësore që t'i pajisim nxënësit tanë me kompetenca digjiitale shumë të nevojshme për të pasur sukses në një botë gjithnjë e më digjiitale.

E kuptoj që ky kalim drejt digjitalizimit mund të duket i frikshëm, veçanërisht për ata që japin mësim prej shumë vite. Megjithatë, ju siguroj se me mbështetjen dhe burimet e duhura, ky tranzicion mund të menaxhohet lehtë dhe të shpejtë frytet e saj. Ne jemi të përkushtuar t'ju ofrojmë mjetet dhe formimin që ju nevojitet për të pasur sukses në mësimdhënien me bazë teknologjinë.

Ju inkurajoj të përqafojmë mundësitë që ofron digjitalizimi. Duke përfshirë platforma dhe përmbajtje digjiitale në procesin mësimor, ju mund të krijoni përvoja të nxëni tërheqëse dhe ndërvepruese që do të frymëzojnë dhe motivojnë nxënësit tuaj. Ju mund të përdorni teknologjinë për të personalizuar të nxënin dhe për ta përshtatur atë me nevojat e secilit nxënës. Ju gjithashtu mund të bashkëpunoni me mësues të tjerë, si në nivel institucional ashtu dhe më gjerë, për të ndarë praktikatat më të mira dhe format inovative të mësimdhënies.

Dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për gjithçka që bëni për të frymëzuar dhe edukuar të rinjtë tanë. Përkushtimi juaj ndaj nxënësve është vërtet i admirueshëm dhe do të doja mbështetjen tuaj ndërsa nisim këtë rrugëtim emocionues të digjitalizimit në edukim. Së bashku, do të bëjmë të mundur përgatitjen e nxënësve të arsimit profesional për të ardhmen digjiitale.

Përzemërsisht,

Ejvis Gishti

Drejtor i Përgjithshëm

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PARAFJALË

Inovacioni është fjalë kyçe e ditëve të sotme. Të gjithë sektorët, fushat, bizneset e deri tek individët e thjeshtë e kanë kuptuar rëndësinë e tij, si çelës suksesi drejt së ardhmes. Nëpërmjet inovacionit, ne spikatim mes të tjerëve, sjellim ndryshimin, përmirësojmë financat tona apo edhe mund të bëhemi pjesë e historisë... Por ka një fushë dhe një profesion ku inovacioni shihet ndryshe, dhe këto janë edukimi dhe mësuesi. Në edukim, inovacioni nuk përkthehet në famë e as në të ardhura. Një mësues inovator nisët, para së gjithash, nga besimi se, nëse procesi mësimor ecën me hapin e kohës, brezat e rinj do të jenë më të aftë në profesionet e tyre, më të zotë për t'iu përshtatur dinamikave të kohës dhe më të denjë si qytetarë. Me këtë pikësynim, në mbarë botën po promovohet gjithnjë e më shumë mësimdhënia dhe të nxënët me bazë teknologjitë digjitale, duke u ofruar nxënësve një përvojë më të pasur të nxëni. Diku, një mësues fokusohet te modernizimi i procesit të vlerësimit të nxënësve nëpërmjet opsioneve që ofrojnë platformat digjitale. Dikush tjetër sjell risi duke shfrytëzuar mundësitë e ndërveprimit online me nxënësit. Një tjetër mësues merr përsipër të ndihmojë kolegët në digjitalizimin e orëve të mësimit... e kështu me radhë, të gjithë me dëshirën për të përqaftuar të renë dhe për të ecur drejt së vetmes rrugë të duhur: zhvillimit.

Në këtë botim, 10 mësues të shkollave të mesme profesionale partnere të projektit "Aftësi për Punë" ndajnë me ju disa praktika të mira në gjetjen dhe aplikimin e inovacionit në edukimin profesional, bazuar në zgjedhje digjitale. Për lehtësi praktikat janë ndarë në 5 seksione, kushtuar aspekteve të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit me bazë teknologjinë dhe digjitalizimin. Secili rast vjen i strukturuar në mënyrë të tillë që të jetë sa më i kuptueshëm, për t'iu replikuar me sukses nga mësues të tjerë.

Ju ftojme të njiheni me këto praktika, duke kuptuar si pasiguritë fillestare dhe sfidat e ndeshura, ashtu edhe përfitimet dhe impaktin që këto nisma kanë, për të qenë më gati e për t'i bërë edhe ju pjesë të teknikave dhe qasjeve tuaja të mësimdhënies.



A.

MATERIALET
MËSIMORE
DIGJITALE

Zhvillimi i teknologjisë, aksesit në informacion nëpërmjet burimeve të ndryshme, si dhe qarkullimi i shpejtë i tij, ka ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si zhvillohet mësimdhënia dhe të nxënësve. Sot, shumë më tepër se sa me vënie në dispozicion të një informacioni të saktë, të mbështetur në kurrikul, vëmendja po zhvendoset drejt mënyrës sesi të nxënësve realizohet. Synimi bazik i mbajtjes mend dhe riprodhimit të koncepteve ka përfunduar tashmë, duke i lënë vendin aftësimin të nxënësve në punë kërkimore, analizë, vlerësim dhe shprehje kreativiteti. Një qasje e tillë i pajis nxënësit me aparatet e aftësive aq të kërkuara në tregun e sotëm të punës, duke i bërë ata më kompetentë në fushën digjitale, në punën në ekip apo në mënyrën se si ndërtojnë mendimin e tyre kritik. Natyrisht, përgjigjia e duhur ndaj këtyre nevojave të tregut të sotëm të punës dhe specifikave të profesioneve që vazhdojnë të ristrukturohen, nuk mund të vijë spontanisht. Ndryshimi duhet të vijë nga baza, nga sistemi arsimor, në të cilin duhet të përshtaten metodat, qasjet dhe strategjitë e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Në thelb të modernizimit të procesit mësimor qëndron edhe krijimi i përmbajtjes mësimore digjitale, mbështetur në materiale mësimore në përputhje me kurrikulën, por që ofrohen në një format krejt ndryshe, shumë më fleksibël, tërheqës dhe angazhues. Këto materiale u vijnë në ndihmë mësuesve për të planifikuar dhe ndërtuar orë mësimore ndërvepruese. Njëkohësisht, nxitin nxënësit drejt punës së pavarur, si dhe u mundësojnë atyre të identifikojnë mënyrat dhe instrumentet më efikase të të nxënësve, falë larmisë së formave të vizualizimit të materialit. Falë vënies në dispozicion të materialeve mësimore digjitale, nxënësit kanë më shumë akses në materialet mësimore, si dhe më shumë mundësi për të punuar me materialet sipas ritmit të preferuar.

Krijimi i materialeve mësimore digjitale nuk duhet kuptuar si një zhvendosje mekanike e përmbajtjes nga formati tradicional në një version digjital. Që një material mësimor digjital të jetë pedagogjikisht i vlefshëm dhe t'i shtojë vlerë procesit të të nxënësve, duhet t'i përmbahet një sërë kriteresh dhe parimeve:

a. Mbështetja në burime të besueshme informacioni:

Materialet mësimore digjitale mbështeten, sipas këtij kriteri, në burime që garantojnë saktësi dhe cilësi të informacionit që përcjellin. Ato rrjedhin nga ekspertë të fushës dhe i drejtohen një audience specifike, me interes të fokusuar. Materialet mësimore digjitale mbështeten në të dhëna të standardizuara, në informacion të verifikuar dhe me natyrë objektive.

b. Përshtatja me tipin e shkollimit, nivelin, skeletkurrikulën dhe rezultatet e të nxënësve:

Në thelb të çdo materiali mësimor, duhet të qëndrojë konteksti mësimor. Po ashtu, përmbajtja duhet t'i përgjigjet rezultateve të të nxënësve. Materialet mësimore digjitale mbështetin arritjen e këtyre rezultateve dhe kontribuojnë në përgatitjen e nxënësve për ciklin vijues të shkollimit apo për tregun e punës.

c. Zbatimi i parimeve bazë didaktike:

Materialet mësimore digjitale duhet të mbështetin një proces të nxënësve të udhëhequr nga parimet bazë didaktike, të tilla si: ndërtimi koherent dhe logjik; ndërthurja e aspekteve teorike me ato praktike; kalimi nga e njohura drejt së resë, nga e thjeshta te më e ndërlikuara, nga e veçanta tek e përgjithshmeja.

d. Përshtatja me profilin e audiencës:

Materiali mësimor digjital duhet të konceptohet në përputhje me karakteristikat dhe nevojat e audiencës së synuar. Grupmosha, niveli i shkollimit apo i kualifikimit, nevojat specifike të nxënësve apo edhe aftësitë digjitale, janë veçori që merren në konsideratë gjatë dizajnimit të një materiali mësimor digjital.

e. Aplikimi i një qasjeje me në fokus nxënësve:

Materiali mësimor digjital konceptohet në mënyrë të tillë që të vendosë nxënësve në qendër të procesit të përvetësimit të njohurive dhe aftësive, pavarësisht nëse gjendet në klasë ose në shtëpi, i udhëhequr nga mësuesi ose duke punuar në mënyrë të pavarur. Nëpërmjet përfshirjes së diskutimeve, sondazheve, detyrave, kuicëve apo lojërave, nxënësi gjen hapësira ku të ndërveprojë, të shprehë pikëpamjet, qëndrimet dhe kreativitetin e tij.

f. Nxitja e ndërveprimit dhe e angazhimit:

Materiali mësimor digjital ofrohet në mënyrë të tillë që të motivojë nxënësve të angazhohen në të. Përmbajtja e bën nxënësve të përfshihen tërësisht në procesin mësimor, ta mbajë të fokusuar dhe aktiv. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet aktiviteteve si kuicet apo sondazhet, përmbajtja digjitale promovon ndërveprimin nxënës-platformë, duke e mbajtur nxënësve të mobilizuar dhe aktiv. Po ashtu, mundësohen ura ndërveprimi ndërmjet mësuesit dhe nxënësve, si dhe mes nxënësve, të tilla si forumet apo detyrat në grup.

g. Mundësimi i instrumenteve të larmishme të vlerësimit dhe i formave të ndryshme të tij:

Materialet mësimore shoqërohen me instrumente të larmishme vlerësimi, të cilat mundësojnë jo vetëm matjen e nivelit të njohurive të nxënësve, por edhe të aftësive të tyre analitike dhe interpretuese, të zgjidhjes së problemeve, të menduarit kritik dhe kreativ. Njëkohësisht, materiali mësimor digjital duhet të bëjë të mundur jo vetëm vlerësimin e mësuesit ndaj nxënësit apo vlerësimin automatik të gjeneruar nga platforma, por edhe vlerësimin mes nxënësve dhe vetëvlerësimin.

h. Të qenët të përditësuar:

Ky kriter shihet në dy aspekte: nga njëra anë, përmbajtja e materialit mësimor digjital duhet të bazohet në të rejtat e fushës përkatëse; nga ana tjetër, materiali përditësohet vazhdimisht nëpërmjet editimeve në mjedisin virtual apo programin e përdorur.

i. Të qenët gjithëpërfshirëse:

Materialet mësimore digjitale janë gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për çdo nxënë, pa i cënuar apo diskriminuar për arsye fizike, kognitive, gjinore, racore, etnike etj. Gjithashtu, ofrohen në një gjuhë sa më të kuptueshme, për të qenë lehtësisht të përvetësueshme nga të gjithë.

Ka një sërë avantazhesh që rrjedhin nga krijimi i përmbajtjes digjitale mbi bazë materiale mësimore:

- Plotësimi i nevojës për materiale mësimore të strukturuar në lëndët ku mungojnë tekstet bazë dhe materialet e tjera mbështetëse.
- Standardizimi strukturor i materialeve mësimore, që ndërthur parimet bazë didaktike me kriteret që duhet të përmbushë një material mësimor digjital.
- Mundësimi i realizimit më efektiv të mësimi, pavarësisht vendit dhe modalitetit.
- Ndryshimi i perceptimit mbi zhvillimin e orës së mësimi dhe procesin e të nxënësit në tërësi, bazuar në materiale dhe veprimtari ndërvepruese, angazhuese dhe motivuese, me protagonist nxënësin.
- Mundësimi i aplikimit të metodës së klasës së përmbysur, për një shfrytëzim optimal të orës së mësimi në lëndë dhe tema me natyrë më praktike, si dhe në ato të bazuara në ushtrime dhe demonstrime (teori në shtëpi – praktikë në klasë).
- Nxitja e punës së pavarur të nxënësve.
- Identifikimi i nevojave për përmirësimin e metodave dhe strategjive mësimore, falë dokumentimit më të mirë të rezultateve të formave të ndryshme të vlerësimit të vazhduar (kuice, ushtrime, detyra, forume etj.)
- Përmirësimi i aftësive digjitale të mësuesve dhe nxënësve nëpërmjet përdorimit të materialeve mësimore në platformë.
- Zgjerimi i konceptit të të nxënësit, duke e nxjerrë nga kufijtë e ngushtë të asaj çfarë ndodh brenda klasës fizike dhe orës mësimore.

Prej vitit 2020, me mbështetjen e projektit “Skills4Jobs”, në bashkëpunim me një ekip ekspertësh pedagogjikë dhe ekspertësh digjitizimi, 46 prej mësuesve të 9 shkollave profesionale partnere janë angazhuar në përgatitjen e materialeve mësimore digjitale me bazë kurrikulën. Plot 71 lëndë të teorisë profesionale dhe 35 module profesionale të drejtimeve dhe profileve të ndryshme kanë tashmë materialet e tyre mësimore të ngarkuara në platformën digjitale mësimore MësoVET, e cila mund të aksesohet nga çdo mësues dhe nxënë. Materialet në platformë shërbejnë si bazë për ndërtimin e orës së mësimi, si dhe mund të pasurohen vazhdimisht me burime dhe aktivitete të tjera për t'u integruar në procesin mësimor.

Në dy rastet e mëposhtme, do të mund të njihemi me përvojën e dy mësuesve, pranë shkollave “Salih Çeka”, Elbasan dhe “Hamdi Bushati”, Shkodër, në lidhje me konceptimin dhe përdorimin e materialeve mësimore digjitale, si modele të mundshme për t'u replikuar edhe në kontekste të tjera mësimore.

Diversifikimi i përvojës digjitale të të nxënit

Julian Kasapi, shkolla e mesme profesionale “Salih Çeka”



Teknologjia ndihmon nxënësin në zhvillimin e aftësive të ndryshme, nga ato bazë e deri tek ato funksionale. Megjithatë, që teknologjia të jetë e suksesshme gjatë aplikimit të saj në mësimdhënie, mësuesi duhet të bëjë zgjedhje të informuara në lidhje me qasjen pedagogjike, nevojat e nxënësit dhe rezultatet e të nxënit. Për mësuesin, sa e rëndësishme është të dijë se për çfarë do ta përdorë teknologjinë, po aq e rëndësishme është të dijë edhe mënyrën se si të nxënit mund të përmirësohet përmes teknologjisë. Këto janë disa nga elementet që Julian Kasapi, mësues në drejtimin TIK pranë shkollës Salih Çeka, Elbasan, merr parasysh gjatë procesit të dizenjimit të një materiali mësimor digjital, për një eksperiencë të nxëni sa më efektive.

DIZENJIMI I NJË MATERIALI MËSIMOR DIGJITAL TË LARMISHËM

Duke e parë në retrospektivë, pas një eksperience 7-vjeçare në mësimdhënie, Juliani konstaton trende të ndryshme në mënyrën se si brezat dëshirojnë të përvetësojnë informacionin e ri. Sipas tij, vitet e fundit, nxënësit kërkojnë larmi në formën se si materiali mësimor përcillet tek ata, si dhe pavarësi në të nxënë. Një tipar i veçantë të brezat e rinj është edhe iniciativa për të sugjeruar se çfarë është më e përshtatshme dhe funksionale për ta, duke rekomanduar ndonjëherë risitë e fundit. Kryefjala e tyre: integrimi i teknologjisë në pjesën më të madhe të aktiviteteve që kryejnë.

Me përgjegjësinë e tij si një mësues hartues materiale digjitale, Juliani është munduar të krijojë një mjedis të përshtatshëm për të mbështetur nxënësit në përdorimin e teknologjisë dhe të instrumenteve të ndryshme për të nxitur punën e pavarur, për t'i motivuar dhe për të rritur angazhimin e tyre. Përpos parimeve dhe kriterëve që duhet të ketë parasysh çdo mësues gjatë hartimit të një materiali mësimor digjital, Juliani ndan me ne hapat që ai ndjek gjatë këtij procesi:

Gjatë dizenjimit të materialit mësimor digjital, Juliani përpqet t'u ofrojë nxënësve një përvojë të nxëni të diversifikuar dhe rrjedhimisht mundësi përzgjedhjeje në formën se si ato dëshirojnë t'i marrin njohuritë e reja. Në sajë të përvojës si mësimdhënës, Juliani ka kuptuar se nxënësit performojnë më mirë kur kanë njëfarë kontrolli mbi procesin e të nxënit. Kjo e shtyn atë të përfshijë në materialin mësimor një sërë burimesh informacioni, të cilat nxënësi mund t'i konsultojë dhe t'i përzgjedhë për t'i shfrytëzuar sipas interesit të tij. Gjithashtu, Juliani ekspozon nxënësit me një larmi instrumentesh dhe programesh, për t'u dhënë mundësinë të vendosin mbi atë që i përshtatet më shumë në realizimin e një detyre apo projekti, si dhe në mënyrën se si do ta prezantojnë atë.

NJË PËRVOJË TË NXËNI E DIVERSIFIKUAR

Gama e gjerë e aktiviteteve dhe materialeve, por edhe burimet e ndryshme që përdoren për realizimin e tyre – faqe webi, aplikacione, opsionet në platformat për mësimdhënie – ka rezultuar në një përvojë mësimore të diversifikuar për nxënësit e mësues Julianit, si dhe ka krijuar hapësira për një rrugëtim të personalizuar

1

Hulumtimi në burime të besueshme e të sakta informacioni

2

Konceptimi i aktiviteteve mësimore në përputhje me kurrikulën dhe nevojat e nxënësve

3

Identifikimi i platformave/instrumenteve të ndryshme digjitale për mësimdhënie

4

Përshtatja e materialit mësimor për ta sjellë në formë digjitale

5

Digjitalizimi i materialit në platformën MësoVET

të të nxënit. “Teknologjia në ditët e sotme ofron mundësi të shumta që përmbajtja mësimore, vlerësimi dhe ndërveprimi me nxënësit të ofrohet në forma të ndryshme”, shton Juliani.

Në rastet kur ai dëshiron që informacioni të vijë edhe në formën e një videoje, ai kërkon në YouTube, Vimeo, ose i krijon vetë ato duke përdorur Canva, FlexClip, Zoom. Videot interaktive mund të krijohen edhe në MësoVET, duke përdorur opsionin Interactive Video. Që përmbajtjes digjitale të mos i mungojë elementi i ndërveprimit edhe kur nxënësi është duke mësuar në kushtet e shtëpisë, Juliani sugjeron përdorimin e forumeve, të cilat mund të shërbejnë si në fazën e aktivizimit të njohurive ekzistuese, ashtu edhe në atë të vlerësimit të njohurive të reja. Në kuadër të kësaj të fundit, kuicet janë një element që gjendet shpesh në materialet mësimore të hartuara prej tij. Ato vijnë në funksion të vlerësimit të vazhduar të nxënësve, por edhe të vetëvlerësimit, si një proces vetëdijësimi mbi pikat e forta dhe të dobëta që ata kanë, si dhe nevojat për përmirësim. Kuicet mund të vijnë në formën e një loje argëtuese duke përdorur Kahoot, Mentimeter, si dhe në formën e vetëvlerësimit, nëpërmjet kuiceve në MësoVET me anë të feedback-ut automatik që i paraqitet çdo nxënësi, si në përgjigjet e gabuara, ashtu edhe në ato të sakta.

Duke qenë se mësues Juliani formon nxënësit të drejtimin TIK, një formë efektive që ai përdor me nxënësit e tij

për të praktikuar njohuritë e marra, është përdorimi i dy burimeve të hapura, W3Schools dhe Codecademy, të cilat shërbejnë si platforma kodimi për gjuhë të ndryshme programimi. Platforma të ngjashme në shërbim të mësimdhënies, janë të aksesueshme për të gjithë dhe mbulojnë lëndë të profiëve të ndryshme, duke përfshirë dhe ato të përgjithshme, si: matematikë, kimi, fizikë. Padyshim që këto platforma ofrohen në gjuhën angleze, por kjo nuk është një pengesë për brezat e rinj, të cilët në shumicën e kohës informacionin për interesat e tyre jashtëshkollore, e marrin në këtë gjuhë.

Nëpërmjet integrit të burimeve të ndryshme në përvojën e të nxënit, çdo nxënësi i jepet mundësia të kuptojë se, për të vënë në jetë idetë apo projektet e tyre, sot nuk ekzistojnë kufij, as në gamën e burimeve e as në mënyrën se si ato përdoren. Përpara nxënësve hapen pista të reja të të nxënit, të cilat i ftojnë drejt eksplorimit, përzgjedhjes, eksperimentimit dhe, në një plan të përgjithshëm, drejt personalizimit të mënyrës së të nxënit.

DISA HAPA PËRPARA, POR ME PENGESA PËR T’U KAPËRCYER

Si çdo ndryshim që ka për qëllim përmirësimin e një procesi, edhe integrimi i teknologjisë në materialin dhe procesin mësimor vjen me vështirësitë e tij. Por nëse kjo frymë ndryshimesh dhe mënyrë e re e të punuarit brendësohet nga të gjithë, ne nuk do të gjendemi

Impakti pozitiv

- Dalja nga proceset klasike të të nxënit duke nxitur hulumtimin, duke ekspozuar nxënësit me burime të ndryshme;
- Fokusimi jo vetëm te produkti/finalizimi, por edhe te procesi i të nxënit;
- Mundësi përzgjedhjeje mes mjeteve të të nxënit në shërbim të një rrugëtimi të personalizuar;
- Motivimi i nxënësve më pasivë në sajë të krijimit të hapësirave dhe mundësive për të shprehur kreativitetin dhe mendimin në forma të ndryshme;
- Zhvillimi jo vetëm i aftësive teknike, por edhe i atyre të ashtuquajtura të transferueshme (aftësi digjitale, hulumtuese, zgjidhje problemi), gjithnjë e më të kërkuara në tregun e punës.

Sfidat

- Roli i mësuesit vihet në diskutim brenda vetes së tij - vështirësi për të kaluar nga roli si burim kryesor i dijes, në mentor dhe lehtësues;
- Hendeku që mund të krijohet mes nxënësve për shkak të mospërputhjes në aftësitë dhe shkathtësitë digjitale mes tyre - disa reagojnë më shpejt dhe më pozitivisht dhe disa kërkojnë më shumë asistim nga mësuesi;
- Sfidat e menaxhimit të procesit mësimor për të shkak të nevojës për të ndjekur ritmin e gjithsecilit dhe për t’i asistuar nxënësit në mënyrë të personalizuar;
- Menaxhimi i klasës kur nxënësit përfshihen në veprimtaritë online, pasi jo gjithmonë ekziston mundësia për t’i vëzhguar ata gjatë punës individuale me mjetet që përdorin .

të vetëm në këtë proces. Përkundrazi, do të gjejmë hapësira për të bashkëpunuar, për t'u përmirësuar e për të ndarë eksperiencë me njëri-tjetrin, duke kapërcyer vështirësitë që mund të hasim gjatë rrugës. Juliani ndan

me ne disa nga impaktet pozitive gjatë përdorimit të materialit mësimor me nxënësit e tij, si dhe sfidat me të cilat është përballur.

E ARDHMJA “TECH” E MËSIMDHËNIES

E ardhmja e edukimit në arsimin profesional, me shumë gjasa, do ta integrojë teknologjinë në çdo qelizë të saj, duke sjellë revolucion në mënyrën se si studentët nxënë dhe se si mësuesit realizojnë procesin mësimor. Juliani pret që, në të ardhmen e afërt, zgjidhjet novatore si Realiteti Virtual (VR) dhe Realiteti i Shtuar (AR), të luajnë një rol të madh në këtë transformim, duke iu ofruar nxënësve qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërvepruese, që nuk limitohen në konceptim dhe imagjinatë, por në një përvojë më të thelluar, ku nëpërmjet simulimeve, aktivizohen të gjitha shqisat. Për shembull, nxënës në drejtime profesionale si Ndërtimi, Shërbime Mjetesh Transporti, Elektroteknikë, Hidraulikë, etj., mund të përdorin VR dhe AR për të vizualizuar dhe ndërvepruar me pajisje dhe sisteme komplekse, duke kuptuar më mirë se si punojnë dhe si t'i riparojnë ose mirëmbajnë ato. Për më tepër, teknologjia e Inteligjencës Artificiale (AI) pritet të personalizojë udhëzimet dhe të ofrojë reagime në kohë reale për nxënësit, duke ndihmuar në përmirësimin e të kuptuarit të proceseve dhe koncepteve e për rrjedhojë, duke rritur shanset e tyre për t'i përvetësuar ato. VR dhe AI nuk është një zgjidhje vetëm në kulturën profesionale, por një vlerë e shtuar edhe në atë përgjithshme, ku nxënësit mund të kryejnë ture virtuale dhe ekzaminime nga afër të trupit të njeriut.

Diversifikimi i përvojës digjitale të të nxënit dhe përfshirja e përvojës virtuale u ofron nxënësve një qasje më praktike ndaj të nxënit, pa shpenzuar në burime dhe duke u mundësuar të punojnë me ide dhe koncepte jo të lehta për t'u realizuar në një mjedis standard arsimor. Vendosi e nxënësit në qendër të përvojës, larmishmëria në aktivitete dhe mjediset ku ata zhvillojnë njohuritë, i lënë ata të provojnë dhe gabojnë në rrugën e tyre drejt suksesit. Për këtë arsye, mësues Juliani mundohet të mbështetë dhe të promovojë integrimin e teknologjisë në procesin mësimor, pavarësisht mënyrës se si ajo aplikohet në mësimdhënie, pasi për të ky është një hap i domosdoshëm dhe i paevitueshëm drejt transformimit digjital.

Materiali mësimor digjital si bazë e orës së mësimimit

Silvana Bushi, shkolla e mesme profesionale "Hamdi Bushati"



Mënyra se si të rinjtë dëshirojnë të përftojnë informacion, ka marrë një trajtë tjetër dekadën e fundit, duke i drejtuar mësimdhënësit drejt qasjeve të reja që ata përdorin në transferimin e informacionit. Kalimi nga mësimdhënia me në qendër mësuesin në atë me në qendër nxënësin kërkon fleksibilitet në procesin mësimor, për t'iu përgjigjur tipologjive të ndryshme të nxënësve dhe për të nxjerrë në pah potencialin e gjithsecilit. Zhvillimi teknologjik dhe integrimi i saj në fushën e edukimit është një mbështetje për mësimdhënësit gjatë aplikimit të këtyre qasjeve bashkëkohore. Realizimi me sukses i një ore mësimore të mbështetur në teknologji, kërkon plotësimin e disa kushteve paraprake të nevojshme, siç janë infrastruktura në klasë, materiali mësimor i përshtatshëm për këtë formë të nxëni, si dhe aksesueshmëria në të. Falë teknologjisë në tërësi dhe digjitizimit në veçanti, sot përmbajtja mësimore me bazë kurrikule vjen edhe në formë digjitale, duke krijuar mundësi për të ndërvepruar edhe në mjedise virtuale. Mësuesve dhe nxënësve u krijohen kështu kushtet e nevojshme për të punuar me një material mësimor interaktiv, i cili shërben gjithashtu si strukturë aktivitetesh për orën mësimore.

MATERIALE MËSIMORE DIGJITALE: NJË KUSHT PARAPRAK PËR NJË ORË MËSIMORE BASHKËKOHORE

Realizimi i mësimdhënies me bazë teknologjinë është një vlerë e shtuar për orën mësimore. Transferimi i informacionit facilitohet nga mjetet e përdorura, ora bëhet më tërheqëse dhe nxënësit janë më të interesuar për të nxënë. Por, përfshirja e teknologjisë në orën e mësimimit ka nivele të ndryshme, nga ato bazike, ku mësuesi mund të përcjellë informacionin e ri nëpërmjet një monitori dhe një prezantimi në PowerPoint, deri tek ato më të avancuara, ku benefitet për nxënësin rrjedhin nga pjesëmarrja aktive e tyre në aktivitete online gjatë orës mësimore. Disponimi i materialeve mësimore digjitale në platformën MësoVET i ka mundësuar Silvana Bushit, mësuese në drejtimin Hoteleri Turizëm pranë shkollës "Hamdi Bushati", Shkodër, përfshirjen e avancuar të teknologjisë në klasë, duke mundësuar aplikimin e formave të reja të mësimdhënies me në qendër nxënësin.

Mënyra e strukturimit të këtyre materialeve digjitale ka orientuar mësuese Silvanën për renditjen e veprimtarive mësimore, si dhe u ka dhënë mundësi nxënësve të saj të angazhohen konkretisht në këto veprimtari. Kjo ndodh pasi materialet mësimore janë zhvilluar dhe digjitizuar në platformën MësoVET, duke ndjekur me saktësi skeletkurrikulën e ofruar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

(AKAFPK). Ato përfshijnë një gamë të gjerë burimesh, të tilla si: tekste të shoqëruara me imazhe, video, kuize interaktive dhe forume. Këto materiale mund të aksesohen nga mësuesja dhe nxënësit në çdo kohë dhe nga çdo stacion pune, për sa kohë që ata kanë një lidhje interneti, një kompjuter apo një pajisje celulare. Mësuese Silvana shprehet se materiali mësimor i ardhur në formatin digjital i ka mundësuar nxënësve të saj një përvojë mësimore më interaktive, të personalizuar dhe fleksibël, qëllime të cilat kërkojnë të arrihen gjatë implementimit të qasjeve të reja në mësimdhënie.

SI PËRDORET PËRMBAJTJA DIGJITALE NGA MËSUESJA?

Gjatë realizimit të një ore mësimore tradicionale, ku shpjegimi dhe prezantimi mbushin pjesën më të madhe të orës mësimore, Silvana kuptoi se nxënësit hasnin vështirësi në përqëndrim dhe se interesi dhe përfshirja aktive e tyre ishte e ulët. Nga ana tjetër, ajo vetë ndihej e limituar në mundësitë dhe kohën që kishte në dispozicion të vlerësimit, duke e bërë të vështirë si identifikimin e aspekteve për përmirësim, ashtu edhe dhënien e një feedback-u të personalizuar mbi progresin e gjithsecilit. Aksesimi në materialet mësimore digjitale në lëndët që mësuese Silvana zhvillon, i hapi rrugë të reja në qasjet që ajo përdor në mësimdhënie, si dhe në mënyrën se si ajo ndërvepron me nxënësit e saj.

Materialet mësimore digjitale mund të integrohen në një sërë mjedisesh, duke përfshirë klasën tradicionale,



mësimin e kombinuar, si dhe mjediset virtuale të të nxënësve. Kjo i ka krijuar hapësira mësueses për t'i përdorur materialet me nxënësit e saj në të gjitha dimensionet që ato ofrojnë. Një nga format është përfshirja e nxënësve në larminë e aktiviteteve të ofruara në përmbajtjen digjitale, të tilla si: zhvillimi i diskutimeve, krijimi i resë së fjalëve, dhënia e informacionit të ri herë në formën e teksteve online ose e-librit e herë në formën e videove, realizimi i kuicëve e lojërave interaktive, etj. Të gjitha këto aktivitete i përgjigjen stilit dhe nevojave unike që gjithsecili nga nxënësit ka në të nxënë. Angazhimi dhe interaktiviteti nuk kufizohet vetëm në orën mësimore në klasë, por i kalon kufijtë e saj. Nxënësit mund të bëhen pjesë e diskutimeve dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin përtej orës mësimore nëpërmjet forumeve të integruara brenda përmbajtjes digjitale në platformën MësoVET, si dhe mund të përdorin hapësirën e chat-it për komunikim virtual me njëri-tjetrin. Një element tjetër që mësuese Silvana përmend dhe që nuk gjendet në formën tradicionale të mësimdhënies, është kuici i ardhur në formën e vetëvlerësimit, nëpërmjet feedback-ut automatik që nxënësi merr në momentin kur e kryen atë, si dhe kuici i ardhur në formën e konkurseve/lojës, duke përdorur aplikacionet e posaçme.

Të gjitha elementet e lartpërmendura nga mësuese Silvana mundësojnë jo vetëm një të nxënë të personalizuar, por edhe kushtet e nevojshme për një punë të pavarur të nxënësit në ambientet e shtëpisë. Falë materialeve mësimore të ardhura në formë digjitale, mësuesja arrin të realizojë me sukses aplikimin e klasës së përmbysur, si dhe kombinimin brenda orës mësimore të veprimtarive online me ato ballë-për-ballë.

PËRMBAJTJA MËSIMORE NË MËSOVET: BENEFITE JO VETËM PËR NXËNËSIN, POR EDHE MËSUESIN

Tashmë platforma MësoVET është pasuruar me përmbajtje mësimore me një numër të madh lëndësh dhe modulesh në 7 drejtime, duke mbështetur procesin mësimor dhe mësuesit në të gjitha shkollat profesionale në Shqipëri që ofrojnë këto drejtime. Si njëra prej mësuesve që ka përqafuar përdorimin e materialeve digjitale që në momentet e para të ngarkimit në platformë, mësuese Silvana ndan benefitet që ka marrë nga kjo mundësi. Sipas saj, aksesimi në këto materiale e ka ndihmuar jo vetëm gjatë punës me nxënësit në kuadër të procesit mësimor, por edhe gjatë punës së saj individuale. Në kontekstin e kësaj të fundit, përmbajtja digjitale i ka shërbyer mësuese Silvanës në këto aspekte:

Burimi i hapur dhe i besueshëm i informacionit

Materialet mësimore në platformën MësoVET vijnë në formën e burimeve të hapura dhe të besueshme të informacionit, falas dhe të disponueshme si për mësuesit, ashtu edhe për nxënësit. Çfarë sheh Silvana si një aspekt shumë pozitiv është mundësia jo vetëm për t'i përdorur ato, por gjithashtu për t'i përditësuar dhe përshtatur me elemente dhe funksionalitete sipas nevojës. Kjo e ndihmon mësuesen për ta përdorur platformën si një depo materiale, të cilat shtohen dhe përditësohen çdo vit.

Material i përshtatur me kurrikulën

Prania e materialeve mësimore digjitale, të ndërtuara mbi bazën e kurrikulës, ka krijuar një efekt komforti dhe sigurie të mësuesja, e cila mund t'i përshtatë ato sipas fazave të orës së mësimi, gjithnjë në përputhje me synimet e lëndës. Mësuesja ndjen se materialet mësimore digjitale e kanë lehtësuar dhe plotësuar rolin e saj gjatë orës së mësimi, duke shërbyer si mbështetje në strategjitë që aplikon, si dhe si nxitëse të angazhimit të nxënësve përgjatë orës mësimore.

Material i kontekstualizuar në fushën e arsimit profesional

Hartimi i përmbajtjes mësimore nga ekspertë të arsimit profesional dhe jo vetëm, e kanë bërë më të thjeshtë dhe efektive përvetësimin dhe zbatimin e koncepteve nga ana e nxënësve, pasi ato vijnë të kontekstualizuara me fushën apo industrinë specifike që ata studiojnë, duke marrë gjithashtu në konsideratë moshën e tyre. Shembujt e shumtë të ofruar dhe rastet studimore i kanë shërbyer mësueses për të ndihmuar nxënësit të shohin konceptet që ato mësojnë se si aplikohen në jetën reale dhe si mund të zbatohen në karrierën e tyre të ardhshme.

Facilitues në planifikimin e orës mësimore

Në të njëjtën kohë, materialet mësimore digjitale e ndihmojnë mësuesen të planifikojë në mënyrë efikase dhe eficiente orën e mësimit. Bazuar në këtë material dhe mundësitë për ndërveprim, mësuesja e ka të thjeshtë të përcaktojë se cilat veprimtari do të realizojë

duke përdorur materialin në trajtë prezantimi orientues gjatë orës së mësimit, cilat veprimtari do t'i kryejë me pjesëmarrjen aktive të nxënësve në platformë, si dhe cilat veprimtari kanë më shumë vlerë t'i zhvillojë në formatin tradicional ballë-për-ballë.

NJË PRESPEKTIVË E RE NË METODAT E MËSIMDHËNIES

Nga njëra anë, materialet mësimore digjitale kanë shërbyejnë si katalizatorë për aplikimin e metodave të reja të nxënësve, duke ofruar përmbajtje interaktive dhe tërheqëse që zgjojnë interesin e nxënësve. Mësuese Silvana sjell shembullin e videove, që u ofron nxënësve eksperiencë ndryshe të nxënësve, ku demonstrohen procese të vështira për t'u replikuar në një mjedis tradicional në klasë. Për më tepër, materialet digjitale ofrojnë një sërë burimesh multimediale, duke mbështetur stile të ndryshme të të nxënësve, të tilla si video për nxënësit vizualë, regjistrime audio për nxënësit dëgjimorë dhe kuice interaktive për nxënësit kinestetikë.

Nga ana tjetër, materialet mësimore digjitale janë një hap i parë dhe lehtësues për mësuese Silvanën drejt aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies, të tilla si mësimi i kombinuar, i cili ndërthur aktivitetet online dhe ato ballë-për-ballë, dhe në veçanti klasa e përbysur, ku nxënësit njihen paraprakisht me materialin mësimor në shtëpi dhe angazhohen me aktivitete të tjera ndërvepruese në klasë. Për më tepër, materialet mësimore digjitale kanë rezultuar efektive për mësuese Silvanën në bashkëpunimin dhe komunikimin midis nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të, duke ofruar një hapësirë virtuale për diskutim, ndarje eksperiencash dhe shkëmbim njohurish.





B.

DISKUTIMI
PËRMES
PLATFORMAVE
DIGJITALE
SI NXITËS I
ANGAZHIMIT
GJATË DHE
PËRTEJ ORËS
MËSIMORE

Në formatin tradicional të mësimdhënies, nuk ka qenë në fokus fakti nëse procesi i të nxënësve vijonte përtej orës së mësimi, ashtu si edhe komunikimi mes mësuesit dhe nxënësit. Të nxënësve konceptohej brenda për brenda klasës dhe ishte rrjedhë e thuajse ekskluzive e asaj që mësuesi arrinte t'i transmetonte nxënësit përgjatë harkut kohor në dipozicion. Në ditët e sotme, në kushtet e ndryshimit të qasjes ndaj të nxënësve, duke synuar transformimin e mendësisë, mësuesit synojnë gjithnjë e më shumë që ora e mësimi të konsiderohet vetëm si një pjesë e procesit të të nxënësve, ku mësuesit mund të ndërveprojnë ballë për ballë me nxënësit e tyre. Përsosja e mjeteve teknologjike dhe digjitale të përdorura për mësimdhënie, kanë mundësuar që komunikimi dhe ndërveprimi mësues-nxënës të shtrihet edhe përtej orës së mësimi, duke mos njohur limit kohe apo vendi, si dhe duke u vënë në jetë thjesht nëpërmjet zotërimit të një pajisjeje digjitale.

Përdorimi i platformave digjitale mësimore është kthyer në një trend të mirëfilltë, me përhapje gjithnjë e më të gjerë në mbarë botën. Të integrosh platforma të tilla në mësimdhënie dhe të nxënësve, do të thotë të shumëfishosh format e zhvillimit të një veprimtarie mësimore, të zgjerosh hapësirat për ndërveprim dhe të aftësosh nxënësit në punën e pavarur. Në të njëjtën kohë, platformat mësimore digjitale janë edhe sinonim

i promovimit të një qasjeje të re ndaj të nxënësve, që nuk penalizohet as nga faktori kohë dhe as nga vendi ku mund të gjendesh.

Të gjitha këto avantazhe mishërohen më së miri edhe në diskutimet virtuale, të cilat, të përdorura në kontekstin mësimor, krijojnë mundësi të shumta për ndërveprim, si gjatë orës së mësimi, ashtu edhe në pjesën tjetër të ditës së nxënësit dhe të mësuesit. Falë diskutimeve në platformat digjitale, të organizuara kryesisht në trajtën e tabelave interaktive apo të forumeve të ndryshme, mësuesit dhe nxënësit kanë mundësi të jenë në kontakt të vazhdueshëm me njëri-tjetrin, duke shkëmbyer ide, mendime apo burime të vlefshme informacioni. Në formate të tilla, asnjë nuk mbetet i përjashtuar, pavarësisht nëse ndërveprimi ndodh në klasë apo në shtëpi, përgjatë minutave të mësimi apo në orët e vona të natës, nga ana e nxënësve më të guximshëm për t'u shprehur apo nga ata më të ndrojtur.

Por kjo nuk është gjithçka. Diskutimet që realizohen në platforma digjitale, si gjatë orës së mësimi, ashtu edhe përtej saj, janë gjithashtu mjete të shkëlqyera për të nxitur angazhimin e vazhdueshëm të nxënësit. Kjo "nxitje digjitale" e angazhimit ka një efekt të shumëfishtë:

Realizimi i diskutimeve në formatin digjital ndikon pozitivisht edhe në aftësinë e nxënësve për të strukturuar

1

Së pari, eksperiencia e të ndërvepruarit përmes platformës –preferencë e të rinjve të sotëm - rrit interesin në raport me procesin e të nxënësve. Nxënësit, për rrjedhë, ndihen më të motivuar dhe shtojnë përpjekjet e tyre për të rritur performancën.

2

Së dyti, ndërveprimi online rrit vetëbesimin te nxënësit, të cilët ndihen më të lirshëm të ndajnë me shkrim mendimet e tyre, falë mundësive për të riformuluar postimet dhe për të ruajtur anonimat.

3

Së treti, falë punës në platformë, nxënësit zhvillojnë më tej intuitën e tyre digjitale, duke u familjarizuar më shumë me përdorimin e platformave dhe mjeteve të tjera digjitale në funksion të të nxënësve.

dhe shprehur më mirë pikëpamjet dhe qëndrimet personale, falë kohës më të gjatë në dispozicion për të reflektuar. Këto diskutime ndihmojnë edhe në mprehjen e aftësive konjiktive të nxënësve, të tilla si: arsyetimi i bazuar në fakte, zbërthimi i ideve komplekse, të menduarit abstrakt apo zgjidhja e problemeve. Për më tepër, përballja me një larmi opinionesh i ndihmon nxënësit të jenë më të hapur ndaj mendimit ndryshe, si dhe më konstruktivë në mënyrën se si komentojnë dhe diskutojnë. Përfitime të shumta kanë edhe mësuesit,

të cilët mund t'i shohin këto diskutime nën optikën e vlerësimit të vazhduar, duke u bazuar në interesin ndaj tematikave, dinamikën e ndërveprimit dhe cilësinë e inputeve për të rishikuar dhe përshtatur metodat e mësimdhënies.

Por, ç'mund të bëjmë ne, si mësues, për të rritur efektivitetin e diskutimeve online? Ja disa këshilla të vlefshme:

1

Përzgjidhni një temë diskutimi që krijon hapësirë për të shprehur opinione personale!

2

Nga një diskutim online në tjetrin, krijoni diversitet në mënyrën e formulimit të temës, duke e sjellë herë në trajtë pyetjeje të drejtpërdrejta e herë në formën e një shembulli apo situatë konkrete.

3

Pavarësisht temës së përzgjedhur, formulojeni atë në mënyrë domethënëse, që nxënësve t'u përcillet qartë objekti i diskutimit!

4

Qëndroni aktiv duke komentuar mbi inputet e nxënësve dhe duke shprehur edhe mendimin tuaj!

5

Përpiquni të vendosni një ekuilibër në mënyrën se si ndani mendimet tuaja me nxënësit, duke u treguar korrektë e të matur, por njëkohësisht edhe të sinqertë!

6

Kur konstatooni se një temë e caktuar zgjon më tepër interes te nxënësit, mos e kufizoni në kohë ndërveprimit, por vijoni edhe më pas të komentoni dhe të hapni shtigje të reja diskutimi!

7

Krijoni një mjedis dinamik dhe të pasur ndërveprimi virtual, duke mos u mjaftuar vetëm me postime opinionesh dhe komentesh, por duke u ofruar nxënësve edhe burime interesante informacioni, video apo artikuj!

Diskusimet mes nxënësve, si brenda dhe jashtë klase, për tema nga më të ndryshmet, janë të pashmangshme. Duke mos dashur t'i ndërpresin ato, por përkundrazi, t'i shfrytëzojnë duke i kanalizuar drejt temave që lidhen ngushtë me orën mësimore, si dhe duke i sjellë në forma ku nxënësit ndihen më komfort për t'u shprehur, mësuesit janë drejtuar drejt platformave online të diskutimit. Në vijim, do të njihemi me dy praktika të mira të përdorimit të platformave digjitale për realizimin e diskutimeve në shkollën "Gjergj Canco", Tiranë dhe "Hamdi Bushati", Shkodër, bazuar përkatësisht në tabelën interaktive Padlet dhe në forumin online në platformën MësoVET.

Platformat ndërvepruese si mjet për rritjen e angazhimit të nxënësve gjatë orës së mësimi

Jonida Haxhi, shkolla teknike elektrike “Gjergj Canco”



Transformimi i sistemit arsimor në mbarë botën është reflektuar në të gjitha dimensionet e mësimdhënies dhe të nxënësve, duke përfshirë edhe ndërtimin e orës mësimore. Deri para pak kohësh, ora organizohej tipikisht rreth tri aktiviteteve: riprodhim i njohurive të mëparshme nga ana e nxënësit, shpjegim i koncepteve kryesore nga mësuesi dhe matje e njohurive të sapo fituara nëpërmjet detyrave të klasës, në mënyrë individuale. Ora mësimore i ngjasonte kështu kalimit mekanik të një stafete, herë në duart e mësuesit dhe herë në duart e nxënësit, ndërkohë që hapësirat për ndërveprim dhe shkëmbim opinionesh, idesh dhe përvojash, ishin tejet të kufizuara. Sot, veprimtaritë gjatë orës mësimore janë nga më të larmishmet, duke u fokusuar te nxënësi dhe duke u përpjekur të nxitin mendimin ndryshe dhe kreativitetin. Me këtë synim, një ndër veprimtaritë e shpeshta mësimore janë edhe diskutimet. Por jo të gjithë nxënësit reagojnë njëllëj përballë diskutimit, veçanërisht në tematika të caktuara. Disa hezitojnë të ndajnë mendimet e tyre për shkak se janë më të ndrojtur, ndërsa të tjerë i druhen gjykimit të shokëve. Si rezultat, në jo pak raste, diskutimet zhvillohen me aktivizimin e vetëm një pjese të vogël të nxënësve.

Në shkollën Teknike Ekonomike në Tiranë, mësuese Jonida Haxhi është ndeshur vazhdimisht me një sfidë të tillë gjatë realizimit të diskutimeve, por ka gjetur një mënyrë efektive për ta kapërcyer.

PLATFORMA PADLET: NGA NEVOJA TE ZGJIDHJA

Mësuese Jonida është e bindur se çelësi i suksesit të orës së mësimi qëndron te pjesëmarrja aktive e nxënësve. Për këtë, e konsideron diskutimin si një mjet shumë efikas për t'i mbajtur ata të angazhuar në procesin mësimor. E gjendur mes një kontigjenti nxënësish me natyrë të ndryshme, nga më introvertët tek ata më ekspresivë, nga më aktivët tek ata më indiferentë, mësuese Jonida i është drejtuar një zgjidhjeje digjitale. Mes mjeteve të shumta që mund të përshtaten për diskutime, mësuesja ka përzgjedhur Padlet, një platformë digjitale në formën e një tabele ndërvepruese, e cila ka pamjen e një muri ku mund të “ngjitetsh” postime. Ka një sërë arsyes që e kanë shtyrë mësuesen të zgjedhë pikërisht Padlet:

- lehtësia në përdorimin e platformës nga ana e mësuesit dhe nxënësit;
- ofrimi i paketave falas ose me pagesë të ulët;
- aksesin në çdo kohë, duke lejuar vijimin e diskutimit edhe përtej orës së mësimi;
- shfaqja e inputeve në kohë reale;
- numri i pakufizuar i inputeve;

- mundësia për të dhënë komente apo feedback mbi një postim të caktuar;
- shikimi i të gjitha postimeve në një tabelë të vetme;
- integrimi, krahas tekstit të shkruar, edhe i imazheve, videove, linqeve apo dokumenteve për të mbështetur apo pasuruar diskutimin;
- personalizimi i elementeve të template-ve në përputhje me tematikën;
- ardhja e njoftimeve me e-mail për inputet e reja etj.

PARAPËRGATITJA PËR DISKUTIMIN NËPËRMJET PADLET

Pavarësisht lehtësisë dhe kohës së shkurtër që merr krijimi i një tabele në Padlet, mësuese Jonida tregon se është e nevojshme të realizohet një punë përgatitore para nisjes së orës së mësimi. >>> **Fillimisht**, mësuesja përcakton temën e diskutimit, e cila vendoset në krye të tabelës virtuale dhe që shërben si pikë referimi për nxënësit. Sipas saj, krahas temës apo pyetjes së shtruar


për diskutim, është e këshillueshme të jepet edhe ndonjë detaj shtesë mbi tematikën, për të orientuar më mirë nxënësit nëse diskutimi rimerret në një moment të dytë prej tyre apo për të udhëzuar nxënësit që nuk kanë qenë të pranishëm gjatë asaj ore. >>> **Më pas**, mësuesja merret me aspektin e vizualizimit të tabelës Padlet, duke përzgjedhur imazhin në sfond dhe ngjyrat e shkrimit apo të elementeve të tjera sa më në përputhje me temën e diskutimit. Ndonjëherë, në varësi të tematikës, ajo vendos edhe ndonjë detaj me nota humorit, si për shembull një ikonë apo shënim të këndshëm. Në këtë mënyrë, nxënësit pjesëmarrës në diskutim ndihen më të relaksuar dhe për rrjedhojë, janë më të prirur të shprehin lirshëm mendimin e tyre. >>> **Pas finalizimit të tabelës Padlet**, mësuesja realizon edhe një provë për t'u siguruar për ruajtjen e saj, duke qenë kështu gati për ta përdorur gjatë orës së mësimi.

NJË DISKUTIM I SJELLË NDRYSHE NËPËRMJET PLATFORMËS PADLET

Diskutimet e realizuara nëpërmjet platformës digjitale Padlet janë pjesë e mjaft orëve mësimore të zhvilluara nga mësuese Jonida. Në mënyrë të veçantë, ky instrument ndërveprimi përdoret nga mësuesja në temat mësimore që krijojnë më shumë hapësira për dhënien e opinioneve të nxënësve dhe ndarjen e përvojave të tyre nga jeta e përditshme. Në orët e para të bazuara në diskutimet në Padlet, mësueses i është dashur të japë udhëzime të vazhdueshme për mënyrën e përdorimit të platformës, duke i kushtuar disa minuta shpjegimeve dhe asistimit të nevojshëm të nxënësve. Nxënësit, të mësuar me teknologjinë, programet dhe aplikacionet e ndryshme, u aftësuan shpejt në përdorimin e Padlet, duke e përqafuar menjëherë këtë mjet inovator në orët e tyre të mësimi.


Për diskutimet në Padlet, mësuesja zakonisht parashikon 15-20 minuta, gjatë të cilave nxënësit marrin kohën e tyre për të dhënë inputin në lidhje me tematikën apo pyetjen e përzgjedhur. Për të krijuar një mjedis më komod, ku të gjithë të ndihen plotësisht të lirshëm të shkruajnë atë që me të vërtetë mendojnë, mësuesja në më të shumtën e rasteve, nuk u kërkon nxënësve të shoqërojnë postimin me emrin e tyre. Gjithashtu u thekson atyre se kanë kohë të mjaftueshme në dispozicion për të formuluar me kujdes përgjigjet e tyre, si dhe kanë mundësinë për ta rishikuar atë para postimit. Gjatë pasurimit të tabelës Padlet me postime, mësuesja i ndjek nxënësit nëpërmjet monitorit të vendosur në klasë. Nxënësit kanë mundësi të japin inputin e tyre, të komentojnë përgjigjet e shokëve, por edhe të hapin një tjetër pistë diskutimi nëpërmjet prekjës së çështjeve të

tjera lidhur me tematikën qëndrore. Ndërkohë, për të krijuar larmi në formatet e diskutimeve, por edhe për t'iu përshtatur tematikave të diskutimit, mënyra se si mësuesja ndërvepron me nxënësit është e ndryshme.



MODELI I PARË I NDËRVEPRIMIT:

Mësuesja komunikon virtualisht me nxënësit, duke komentuar mbi përgjigjet e tyre në platformë. Në varësi të kohës në dispozicion, mund të përzgjedhë disa prej postimeve apo t'i komentojë të gjitha. Nxënësit, nga ana e tyre, mund të lexojnë në kohë reale postimet e njëri-tjetrit dhe të mësueses, duke u frymëzuar për të vijuar më tej diskutimin virtual. Krijohet kështu një rrjet diskutimi që pasurohet dhe degëzohet vazhdimisht, në mënyrë të shpejtë.




MODELI I DYTË I NDËRVEPRIMIT:

Mësuesja ndjek postimet dhe ndërveprimin mes nxënësve nëpërmjet ekranit të monitorit dhe komenton me gojë mbi përgjigjet. Sipas tematikës, kategorizon mendimet dhe qëndrimet, veçon ato më interesante apo të ndryshme nga të tjerët, si dhe nxjerr përfundime mbi bazën e tyre, teksa nxënësit mund të vijojnë të angazhohen në formatin tradicional ballë për ballë.

Cilado qoftë mënyra e përzgjedhur për zhvillimin e diskutimit, klasa qëndron e gjallë dhe e mobilizuar gjatë gjithë kohës. Sipas mësueses, strategjia duhet të jetë fleksibël, duke ndjekur reagimet e nxënësve. Pas përfundimit të diskutimit, mësuesja u rikujton nxënësve mundësinë për t'u angazhuar në tabelën Padlet edhe pas përfundimit të orës së mësimit, duke i ftuar ata pasurojnë, në një kohë të përshtatshme për ta, me ide të reja, elemente vizuale apo shembuj konkretizues.

IMPAKTI NGA REALIZIMI I DISKUTIMEVE NË PLATFORMA DIGJITALE

Të zhvillosh një diskutim virtual gjatë orës së mësimit, kur si mësuesja edhe nxënësit janë fizikisht të pranishëm, mund të duket, në një pamje të parë, si një shtysë disi e sforcuar për të përqaftuar përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve digjitale në procesin mësimor. Por përvoja dëshmon se një qasje e tillë, pavarësisht sfidave, ka një impakt me të vërtetë pozitiv, që i kapërcen ndjeshëm kufijtë e orës së mësimit apo të përmbushjes së objektivave mësimorë. Por ku konsiston ky impakt?



Komunikimi dhe të nxëniet përtej orës së mësimit: pjesëmarrja asinkrone në forume

Ermira Mani, shkolla e mesme profesionale “Hamdi Bushati”



Në mjediset mësimore virtuale të përdorura për mësimdhënie e të nxënësve, vend të rëndësishëm zënë edhe forumet që krijohen nga mësuesit për të nxitur bashkëveprimin mes tyre dhe nxënësve, si gjatë orës së mësimit, edhe pas saj. Akses individual në forum dhe mundësia për të shprehur mendimet me shkrim, shërben edhe si qasje gjithëpërfshirëse, ku të gjithë nxënësit, pavarësisht natyrës së mbyllur që mund të kenë apo bindjeve dhe pikëpamjeve, ndihen më komodë dhe konfidentë për t'i ndarë ata me të tjerët. Krjimi i këtyre “dritareve” i ndihmon nxënësit të fitojnë më shumë besim te vetja e tyre, çka ndikon pozitivisht edhe në raportin e tyre me të nxëniet në tërësi. Njëkohësisht, forumet shërbejnë edhe si instrumente kompensimi të pamundësisë së nxënësve për t'u aktivizuar përgjatë qëndrimit në klasë, qoftë edhe thjesht për shkak të kohës së kufizuar apo të menaxhuar jo mirë. Pjesëmarrja në forume përtej orës së mësimit ndikon pozitivisht edhe në realizimin me sukses të orëve të bazuara në vënien në praktikë të njohurive. Mësuesi arrin të planifikojë orën e mësimit duke ia kushtuar kohën kryesisht praktikës, ushtrimeve apo eksperimenteve, ndërkohë që mbajtja aktive e forumeve përgjatë gjithë kohës nuk e privon nxënësin dhe mësuesin për të realizuar edhe diskutimet, si një veprimtari e vlefshme mësimore.

Mësuesit, nga ana tjetër, u drejtohen forumeve për të krijuar ide mbi njohuritë që nxënësit tashmë i kanë fituar dhe konsoliduar, si dhe mbi ato për të cilat kërkohet më shumë angazhim nga ana e mësuesit dhe e vetë atyre. Pasurimi i shpejtë dhe pa kufij i inputeve të nxënësve në forume, i jep mundësi mësuesit të nxjerrë konkluzione të rëndësishme mbi trendet e mendimeve dhe qëndrimeve të nxënësve. E tillë ka qenë edhe eksperiencia e mësuese Ermira Mani në shkollën “Hamdi Bushati”, e cila aplikon që prej periudhës së pandemisë komunikimin me nxënësit nëpërmjet forumeve në platformën MësoVET. Mësuesja shprehet se i ndjek më lehtë diskutimet e tyre online dhe e orienton ndërveprimin në platformë në mënyrë më efektive se sa në klasë.


FORUMI – NJË MJEDIS KU NXËNËSIT NDIHEN TË RELAKSUAR PËR T’U SHPREHUR

Duke përdorur forumet, nxënësit i krijohet hapësira për të riaktivizuar njohuritë e marra dhe për të shprehur mendimet dhe qëndrimet e tij mbi tematika të ndryshme të shtruara. Mësuese Ermira shprehet se nxënësit ndihen të angazhuar gjatë gjithë kohës dhe nuk e humbasin lidhjen me njohuritë dhe aftësitë që u transmetohen. Ata mund të hapin në çdo moment forumet në MësoVET, të shqyrtojnë temat dhe inputin e shokëve të tyre, të njihen me komentet e njëpasnjëshme dhe të nxiten për të dhënë kontributin e tyre. Mësuesja është e mendimit se në një mjedis më të relaksuar, që mund të vizitohet në kohën më të përshtatshme, nga vendi që preferon dhe pa u ndjerë i trysnuar, nxënësi jep më të mirën e tij, duke u ndjerë më i lirshëm për të ndarë opione dhe përvoja, si

dhe për të qenë më kreativ dhe autentik në mënyrën e të analizuarit dhe të interpretuarit. Përdorimi i forumeve si një element i të nxëniet përtej orës mësimore është një vlerë e shtuar për nxënësit në shumë aspekte:

FORUMI SI NXITËS DISKUTIMI DHE HAPËSIRË SHKËMBIMI MES NXËNËSVE

Mësuese Ermira është e mendimit se, nëse dëshirojmë të shohim potencialin e nxënësve për të ndarë mendimin e tyre rreth një teme dhe për të diskutuar në mënyrë konstruktive, forumi është instrumenti i duhur. Shpesh herë, gjatë diskutimeve, në ambientet e klasës krijohet një mjedis kaotik, pasi të gjithë kanë diçka për të thënë mbi temën e hapur dhe shpeshherë, të mbërthyer nga entuziazmi i diversitetit të mendimeve, nxënësit flasin në të njëjtën kohë, duke e bërë të vështirë menaxhimin



e klasës. Prandaj për mësuese Ermirën, zgjidhja më efektive ka qenë shtrimi i një pyetjeje ose ndarja e një situatë rasti në këtë mjedis të dedikuar virtual në platformën MësoVET, ku të gjithë nxënësit kanë mundësi të shprehen dhe të shkëmbejnë idetë dhe pikëpamjet e ndryshme me njëri-tjetrin. Mësuesja shprehet se nxënësit, gjatë periudhës së shkollës së mesme, i japin shumë rëndësi dhe e marrin për bazë informacionin që shkëmbejnë në bisedat mes njëri-tjetrit dhe, ndonjëherë, e vlerësojnë atë më shumë se një informacion i marrë

nga një i rritur. Për këtë arsye, përdorimi i këtij elementi në avantazhin e saj, duke i vendosur nxënësit në pozita shkëmbime mendimesh, ndarje eksperiencash dhe dhënie opinionesh (feedback-u) mes njëri-tjetrit, ka qenë frytdhënëse. Nga ana tjetër, nxënësit me kalimin e kohës, krijojnë një sens përkatësie në raport me këtë komunitet virtual, duke u ndjerë më të hapur për të ndarë bindjet personale dhe për t'u lidhur me njëri-tjetrin në një nivel më personal. Kjo e fundit reflektohet më pas edhe në ambientet e klasës.

FORUMI SI INSTRUMENT VLERËSIMI TË VAZHDUAR

Forumi është një zgjidhje efektive edhe në kuadër të vlerësimit të vazhduar të nxënësve. Këto forume online ofrojnë një platformë për nxënësit që të ndajnë mendimet e tyre, të bëjnë pyetje dhe të bashkëpunojnë në projekte, të cilat janë të dobishme për të matur progresin e tyre në kohë, për të vlerësuar kuptueshmërinë e materialit, si dhe për të vlerësuar aftësi të tjera, si ato të bashkëpunimit dhe komunikimit.

Mundësia për të gjurmuar progresin e nxënësve me kalimin e kohës është një nga përfitimet kryesore të përdorimit të forumeve në kuadër të vlerësimit. Duke monitoruar diskutimet dhe cilësinë e kontributit të secilit nxënës, mësuesit mund të kenë një pasqyrë të qartë se sa mirë nxënësit kanë përvetësuar materialin dhe se ku mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë. Një mënyrë se si mësuese Ermira përdor forumin është gjurmimi i progresit gjatë një projekti në grup. Mësuesja e përdor forumin jo vetëm për të kontrolluar se si kanë ecur grupet me punën dhe çfarë kontributi ka dhënë gjithsecili, por gjithashtu për të komentuar mbi punën e realizuar.

Një avantazh tjetër i përdorimit të forumeve është mundësia për të ofruar reagime të menjëhershme për nxënësit. Duke iu përgjigjur pyetjeve të shtruara nga nxënësit, kjo është veçanërisht e dobishme për ata nxënës që hezitojnë të bëjnë pyetje në një mjedis tradicional të klasës, mësuese Ermira ndihmon për të sqaruar çdo paqartësi apo keqkuptim. Mësuesja gjithashtu sigurohet që diskutimi po ndjek linjën e duhur, nëpërmjet ndërhyrjeve dhe komenteve të saj në kohë reale.

FORUMI SI KONSOLIDUES I AFTËSIVE TË TRANSFERUESHME / TË PUNËSUESHMËRISË

Forumet e diskutimit luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin e aftësive transversale brenda mjedisit të shkollës. Aftësitë transversale janë një grup aftësish të transferueshme në mjedise e kontekste të ndryshme, si të menduarit kritik, zgjidhja e problemit, komunikimi, puna në grup, etj. Këto aftësi janë thelbësore që nxënësit të jenë të suksesshëm në studimet e tyre dhe në karrierën e tyre të ardhshme.


Një nga përfitimet kryesore të përdorimit të forumeve në konsolidimin e aftësive transversale, është aftësia e të mënyrë në mënyrë kritike dhe e zgjidhjes së problemeve. Për shembull, mësuese Ermira i vendos nxënësit e saj

në pozita diskutimi rreth një teme apo u parashtron një problem në lidhje me një temë të trajtuar në klasë, për t'i ndihmuar ata të familjarizohen me këndvështrime të ndryshme, të reflektojnë mbi to në mënyrë kritike, të dinë të formulojnë qëndrimin e tyre, si dhe të japin një zgjidhje në rast problemi. Në këtë mënyrë, mësuesja nxit te nxënësit aftësitë e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemit. Një benefit tjetër është mundësia për të zhvilluar aftësitë komunikuese. Duke u kërkuar nxënësve të shprehin mendimet e tyre në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, forumet ndihmojnë në përmirësimin e aftësive të tyre të të shkruarit dhe të të folurit. Kjo mund të jetë veçanërisht e dobishme për nxënësit që hezitojnë të flasin në klasë. Forumet u ofrojnë gjithashtu nxënësve mundësinë për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, çka i ndihmon ata të zhvillojnë aftësinë e punës në grup dhe lidhshirësit. Gjatë aplikimit të mësimit me bazë projektin, mësuese Ermira krijon nga një forum për secilin grup, ku nxënësit ndajnë punën që realizon gjithsecili në mënyrë individuale, komentojnë punën e njëri-tjetrit dhe mbështetin njëri-tjetrin me materiale shtesë.

Forumi nuk iu ofron nxënësve vetëm një platformë komunikimi virtual, por një dritare drejt të nxënësve aktiv dhe fleksibël. Duke përdorur forumet e diskutimit, mësuesit krijojnë një mjedis mësuesor tërheqës dhe bashkëpunues për nxënësit e tyre. Pjesëmarrja në të tilla formate ndërveprimi, krahas frymëmarrjes që krijon në procesin mësuesor, u mundëson nxënësve të zhvillojnë edhe aftësitë e transferueshme, aq të nevojshme për të qenë të suksesshëm në çdo kontekst të tregut të punës.







REALIZIMI I
VLERËSIMIT
TË NXËNËSVE
NËPËRMJET
PLATFORMAVE
DIGJITALE

Çdo nxënës, student, pjesëmarrës në një trajnim apo në një kurs, ka një ecuri dhe një finalizim të caktuar në përfitimin e kompetencave të synuara. Performanca e nxënësve përgjatë dhe në përmbyllje të një intervali kohor mësimor (një semester, vit shkollor, cikël studimi, program trajnimi etj.) matet nëpërmjet vlerësimit, një proces kompleks që përcakton, planifikon, analizon dhe interpreton informacionin mbi arritjet e nxënësit. Ekzistojnë dy lloje kryesore të vlerësimit: vlerësimi për të nxënë dhe vlerësimi i të nxënëit, të cilat duhet të jenë pjesë integrale e sistemit të vlerësimit që çdo mësimdhënës aplikon. Por ku qëndron dallimi mes këtyre dy tipeve të vlerësimit?

Vlerësimi për të nxënë, i quajtur ndryshe edhe vlerësim formues apo vlerësim i vazhduar, përfshin tërësinë e veprimtarive që realizohen për të kuptuar pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve, si dhe për t'i motivuar ata të përparojnë. Njëkohësisht, ndihmon mësuesit të evidentojnë nevojat e nxënësve duke përshtatur dhe përmirësuar teknikat dhe strategjitë e tyre të mësimdhënies. Ky lloj vlerësimi mund të jetë formal, bazuar në nota, pikë apo shënime referura parametrave të caktuar të vlerësimit, por edhe informal, duke u bazuar edhe në vlerësimet që nxënësit mund të bëjnë për veten e tyre apo për njëri-tjetrin.

Vlerësimi i të nxënëit, i njohur edhe si vlerësimi përmbledhës, konsiston në mbledhjen e të dhënave për të dëshmuar përmbushjen e qëllimeve apo objektivave të vendosur. Vlerësimi i të nxënëit përfshin vlerësimin periodik (p.sh. mujor, 3-mujor, pas çdo moduli trajnimi etj.) dhe përfundimtar të nxënësve, kundrejt një seti të përcaktuar standardesh. Vlerësimi i të nxënëit është në çdo rast formal, bazuar në dokumentim dhe raportim. Pavarësisht dallimeve mes këtyre dy llojeve të vlerësimit, mbi të gjitha është e rëndësishme të kuptojmë se qëllimi i vlerësimit në tërësi nuk kufizohet vetëm në matjen e shkallës së përvetësimit të njohurive dhe të aftësive. Si vlerësimi për të nxënë, ashtu edhe ai i të nxënëit, kanë, para së gjithash, synim përmirësues, në raport me përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të vendosur në kuadër të lëndës, modulit apo programit të trajnimit, si dhe të vetë procesit të mësimdhënies.

Në ditët e sotme, mënyra se si procesi i vlerësimit realizohet, ka ndryshuar dukshëm, jo vetëm në raport me perceptimin e tij nga ana e mësuesve dhe nxënësve, por edhe në format e përdorura për realizimin e tij. Mësimdhënia dhe të nxënëit digjital, bazuar në përdorimin e mjediseve mësimore virtuale, materialeve mësimore digjitale, si dhe programeve apo aplikacioneve të ndryshme online, i ofron një sërë opsionesh procesit mësimor për të rikonceptuar vlerësimin. Qasja digjitale ofron mundësi të shumta si për vlerësimin e vazhduar, ashtu edhe për atë përmbledhës.

Në rastin e vlerësimit të vazhduar digjital, instrumentet që mësuesit mund të përdorin janë nga më të ndryshmet:

KUICET:

- » larmi pyetjesh: me alternativa, e vërtetë/e gabuar, tërhiq dhe lësho, plotësim i vendeve bosh etj.;
- » matje e shpejtë e nivelit të përthithjes së njohurive të mëparshme apo të atyre të sapo fituara;
- » i përshtatshëm për të vlerësuar përmbushjen e objektivave në raport me nivelet bazë kognitive (të mbajturit mend, të kuptuarit, të dalluarit etj.)
- » angazhim i njëkohshëm i të gjithë nxënësve;
- » gjenerim automatik i përgjigjeve;
- » nxjerrje rezultatesh në kohë reale;
- » mjet i përshtatshëm vetëvlerësimi;
- » mundësi ri-testimi;
- » efekt i menjëhershëm ndërgjegjësues mbi përthithjen e njohurive/aftësive dhe mbi ecurinë.

DISKUTIMET NË FORUME:

- » mundësi e shtuar e komunikimit dhe e ndërveprimit mes mësuesit dhe nxënësve, si dhe midis nxënësve;
- » efikase për vlerësimin mes shokëve;
- » përfshirje edhe e nxënësve më pasivë;
- » ideale për të vlerësuar nxënësit bazuar në ndarjen e opinionëve, qëndrimeve dhe eksperiencave;
- » të përshtatshme për vlerësimin e arritjes së objektivave të lidhura me analizën, interpretimin;
- » nxitëse të mendimit ndryshe dhe të kreativitetit;
- » ndërveprim dhe vlerësim pa limite kohe dhe vendi.

SONDAZHET:

- » përgjigje automatike dhe rezultate në kohë reale;
- » marrje e sinjaleve të shpejta mbi efektivitetin e përcjelljes së njohurive;
- » angazhuese dhe tërheqëse për nxënësit;
- » mundësim i integritit të disa sondazheve gjatë orës së mësimit falë shpejtësisë në realizim.

ORGANIZUESIT GRAFIKË:

- » larmi formash vizualizimi;
- » evidentim i nivelit të përthithjes së njohurive falë skematizimit, sintetizimit apo ndërlidhjes;
- » mjet i përshtatshëm për mësuesin për të identifikuar paqartësi dhe mangësi në njohuritë e zotëruara nga nxënësit.

PORTOFOLI ELEKTRONIK:

- » mjet kompleks për vlerësimin e vazhduar;
- » dokumentim efikas i progresit të nxënësve;
- » mundësi për dhënie feedback-u konstruktiv nëpërmjet hapësirave virtuale.

Mjediset virtuale dhe mjetet e ndryshme digjitale krijojnë mundësi për të realizuar vlerësimin përmbljedhës. Në varësi të kontekstit arsimor dhe të ciklit të studimit, mësuesi dhe institucioni mund të zhvillojë në formatin digjital provimet vjetore apo semestrare, ato përmbljedhëse të një grupi kapitujsh apo temash etj. Njëkohësisht, vlerësimi përmbljedhës digjital mund të kryhet edhe kur instrumenti i vlerësimit janë projektet e nxënësve, të cilat u japin mundësi këtyre të fundit të ngarkojnë në platformën mësimore virtuale përmbajtje të ndryshme digjitale si: prezantime, video, imazhe të edituara apo infografikë. Pavarësisht sfidave në raport me zotërimin e aftësive të duhura digjitale dhe varësisë nga infrastruktura fizike dhe digjitale, vlerësimi përmbljedhës digjital është një format i vlefshëm i matjes së standardizuar të njohurive dhe aftësive të nxënësve, falë lehtësive dhe komoditetit që ofron në strukturimin e tij, në korrigjim dhe dokumentim.

Që prej 2019-s, shkollat partnere të projektit 'Aftësi për Punë' kanë aplikuar me sukses vlerësimin përmbljedhës dhe atë të vazhduar nëpërmjet platformave për edukim dhe mjeteve të tjera digjitale. Gjatë vitit të fundit akademik, 2021-2022, 875 nxënës të drejtimeve SHMT, Hoteleri-Turizëm, Ekonomi Biznes, Shërbime shëndetësore e sociale, Elektroteknikë, TIK, etj., kanë realizuar online provimet e Nivelit I dhe II, falë funksionaliteteve që ofron platforma MësoVET. Gjithashtu, përgjatë gjithë vitit shkollor, mësuesit integrojnë platforma të ndryshme në orën mësimore për një vlerësim ndryshe nga ai tradicional, ku procesi është më dinamik e jo i ngurtë.

Në vijim, do të njiheni me dy praktika të mira të sjella nga mësues të shkollës "Gjergj Canco", Tiranë dhe "Ali Myftiu", Elbasan, në lidhje me realizimin e vlerësimit online, si në kuadër të vlerësimit të vazhduar, ashtu edhe në atë përmbljedhës.

Vlerësimi digjital si instrument motivimi

Jurgen Jazaj, shkolla teknike elektrike “Gjergj Canco”



Një ndër qëllimet kryesore të vlerësimit të vazhduar është motivimi i nxënësve. Për këtë arsye, vlerësimit të vazhduar i referohemi edhe si vlerësimi për të nxënë, pra vlerësimi që u jep nxënësve impulse pozitive për t'i përfshirë dhe thëlluar në njohuri dhe aftësi. Një ndër mjetet e përdorura më gjerësisht në kuadër të vlerësimit të vazhduar janë kuicet, të njohura për efektin e tyre motivues. Kuicet nxitin motivimin e brendshëm, i cili, në një kuptim të përgjithshëm tregon se nxënësi, më tepër se sa nga ideja e “shpërblimit” nga mësuesi me pikë, shënim pozitiv apo notë, nxitet nga një dëshirë e brendshme apo nga kënaqësia që sjell përfshirja në një veprimtari të tillë. Kjo formë e motivimit është edhe më e shprehur në rastet kur kuicet zhvillohen online, të integruara në materialet mësimore digjitale, pra në një mjedis mësimor virtual, apo të krijuara më vete, në platforma dhe aplikacione të posaçme. Në fakt, kjo është mëse e kuptueshme nëse mendojmë se sa angazhuese dhe tërheqëse janë kuicet online për secilin prej nesh, me përgjigje që jepen në mënyrë të shpejtë, me diversitet pyetjesh, që ndonjëherë u ngjasojnë edhe lojërave, si dhe me rezultate në kohë reale, duke ofruar kënaqësi pas çdo përgjigjeje të saktë.

Të gjitha këto efekte dhe avantazhe të kuiceve online i ka kuptuar më së miri Jurgen Jazaj, mësues pranë shkollës “Gjergj Canco” në Tiranë, i cili realizon shpesh me nxënësit kuice nëpërmjet aplikacionit Kahoot.

DËSHIRA PËR TË MOTIVUAR NXËNËSIT NËPËRMJET VLERËSIMIT: PIKËNISJA E PËRDORIMIT TË KAHOOT

“Çdo mësues, pavarësisht profilit apo përvojës që ka, i njuh mirë sfidat e ndërtimit të një strategjie efikase për vlerësimin e vazhduar, ku motivimi i nxënësve për t'u përfshirë më shumë në procesin e të nxënës dhe për të performuar më mirë, duhet të jetë kryefjala”. Me këto fjalë e nis diskutimin mësues Jurgeni. Sipas tij, çdo mësues duhet t'i japë rëndësi të veçantë këtij elementi, pasi nëpërmjet tij, nxënësi ndërgjegjësohet dhe motivohet për të dhënë më shumë nga vetja në procesin e të nxënës. Nisur nga kjo bindje, mësuesi ka përzgjedhur të përdorë Kahoot për realizimin e kuiceve online, si mjet i vlerësimit të vazhduar. Por ç'është Kahoot? Bëhet fjalë për një platformë digjitale, e mbështetur në qasjen e të nxënës në formë loje, me një gamë të gjerë opsionesh angazhimi, ku ndër më të përdorurat janë kuicet. Gjatë familjarizimit me Kahoot dhe me veprimtaritë e ofruara prej tij, mësues Jurgeni ka kuptuar qasjen e këndshme, argëtuese dhe motivuese të konceptimit dhe pjesëmarrjes në kuice, duke i bërë pjesë ato të orës së mësimin. Sipas tij, përdorimi i Kahoot nga njëra anë i jep mësuesit indicie mbi progresin individual të nxënësve, si dhe nga ana tjetër, zgjon te nxënësit dëshirën për

rezultate sa më të larta në kuic, duke i nxitur ata drejt përvetësimit më solid të njohurive dhe aftësive.

REALIZIMI I KUICEVE ME ANË TË PLATFORMËS KAHOOT

Kuicet online nëpërmjet platformës Kahoot janë pjesë e shumë orëve mësimore të zhvilluara nga mësues Jurgeni. Ka mjaftuar krijimi i një llogarie dhe eksplorimi i opsioneve të platformës për t'u familjarizuar shpejt me të. Orët e para kanë shërbyer si testuese për këtë instrument. Fillimisht u përdorën opsionet më bazike të platformës, duke krijuar teste tipike me 2-3 pyetje dhe me disa alternativa. Duke parë reagimin pozitiv të nxënësve dhe efektin motivues që u shkaktonte, mësuesi nisi t'i shoqërojë pyetjet e kuicet edhe me imazhe, për t'u ofruar nxënësve një përvojë edhe më angazhuese. Por si vepron konkretisht mësues Jurgeni për përgatitjen dhe zhvillimin e kuiceve në Kahoot? Në pjesën më të madhe të rasteve, mësuesi preferon ta krijojë kuicin paraprakisht, për ta përdorur lehtësisht në klasë në momentin e parashikuar. Mënyra e formulimit të pyetjes dhe e dhënies së alternativave është po ajo që rekomandohet në forma të tilla të matjes së njohurive, duke siguruar formulim të qartë, opsione që lidhen me

pyetjen, si dhe një alternativë të saktë, që nuk mbart dykuptueshmëri. Në raste të veçanta, në varësi të ecurisë së orës së mësimi dhe reagimeve që merr nga nxënësit, mësuesi krijon një kuic edhe përgjatë orës, për të testuar shpejt përthithjen e njohurive. Nxënësit, nga ana e tyre, angazhohen të gjithë në kuic, në pritje të gjenerimit të menjëhershëm të rezultateve, të cilat renditen, ashtu si në një konkurs, sipas pikëve të fituara nga secili (vendi i parë, i dytë, i tretë...). Ndërkohë, mësuesi bën komente mbi to dhe diskuton mbi saktësinë e përgjigjeve. Një qasje e tillë bën të lindë mes nxënësve një konkurrencë e shëndetshme, e cila, kuic pas kuici dhe orë pas ore, përkthehet në rritje të motivimit të tyre për të nxënë.

Kahoot!

KAHOOT SI MBËSHTETËS I FAZAVE TË NDRYSHME TË ORËS SË MËSIMIT


Lehtësia e krimit të kuicit, shpejtësia e realizimit të tij në klasë dhe interesi i shfaqur nga ana e nxënësve, e ka shtyrë mësues Jurgenin ta përdorë platformën Kahoot përgjatë fazave të ndryshme të orës së mësimi.

KAHOOT SI AKULLTHYES:




Me anë të një pyetjeje tërheqëse, pa iu referuar ende njohurive apo aftësive të synuara, mësuesi arrin të mbërthejë vëmendjen e nxënësve dhe të nxitë interesin e tyre ndaj orës së mësimi. Pak rëndësi ka nëse nxënësit pyeten për sportin e tyre të preferuar apo vendin që do të dëshironin të vizitonin. Brenda pak minutave, falë nisjes së orës në një mënyrë të tillë argëtuese, në klasë krijohet një atmosferë e ngrohtë dhe nxënësit shfaqen më të prirur për t'u integruar në veprimtarinë mësimore pasuese.

KAHOOT SI AKTIVIZUES I NJOHURIVE EKZISTUESE:



Në këtë fazë të orës së mësimi, realizimi i kuicit nëpërmjet Kahoot i mundëson mësuesit të krijojë një urë lidhëse mes njohurive të mëparshme dhe atyre të reja, duke matur njëkohësisht qëndrueshmërinë e njohurive tashmë të fituara.

KAHOOT SI MATËS I PËRTHITHJES SË NJOHURIVE TË REJA:



Kjo është edhe mënyra më e shpeshtë se si mësues Jurgeni e përdor këtë platformë digjitale. Gjatë përcjelljes së informacionit të ri, në pikat më kyçe të tij, mësuesi i orienton nxënësit të marrin pjesë në kuicin e përgatitur paraprakisht. Brenda harkut kohor të përcaktuar, nxënësit japin përgjigjet e tyre, teksa mësuesi merr sinjalet e duhura për t'iu rikthyer ndonjë koncepti ende të paqartë apo për të vijuar më tej me transferimin e njohurive.

NJË MJET, SHUMË FUNKSIONE: IMPAKTI I ZHVILLIMIT TË KUICEVE ONLINE

Angazhimi dhe motivimi:

Kuicet online, si në rastin e atyre të krijuara në platformën Kahoot, zhvillohen lehtësisht përgjatë orës së mësimi, duke iu dhënë mundësinë të gjithë nxënësve të angazhohen në to. Nxënësit ndihen më të motivuar të marrin pjesë në një veprimtari të tillë që ofron rezultate në kohë reale mbi performancën e tyre. Duke aplikuar forma të ndryshme të vlerësimit të vazhduar nëpërmjet alternativave digjitale, nxënësit janë më të mobilizuar dhe më të fokusuar përgjatë gjithë procesit mësimor.

Vetëvlerësimi:

Instrumente të tilla rrisin aftësinë e nxënësve për të vlerësuar veten dhe progresin e tyre. Nxënësit kuptojnë më mirë se cilat janë nevojat e tyre, duke kanalizuar në mënyrë më efektive përpjekjet për përmirësim.

Identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta të nxënësve:

Kuice të tilla u mundësojnë mësuesve aplikimin e një forme të thjeshtë dhe të shpejtë të vlerësimit të vazhduar. Në sajë të tyre, mësuesit identifikojnë njohuritë që tashmë nxënësit kanë arritur t'i përvetësojnë, si dhe ato ku kanë më tepër mangësi. Mësuesit krijojnë kështu një tablo më të qartë të ecurisë individual dhe të përbashkët të nxënësve në raport me dijet e reja që fitohen.

Përshtatja më e mirë e metodave të mësimdhënies:

Informacioni i marrë nga kuicet online i ndihmon mësuesit të modifikojnë dhe të përshtatin më mirë strategjitë e tyre të mësimdhënies, si dhe të ri-vlerësojnë efikasitetin e metodave që përdorin. Vlerësimi i vazhduar

digjital, nëpërmjet kuiceve online, shërben kështu edhe si instrument validues i metodave dhe teknikave të mësimdhënies, ku nxënësi, në mënyrë të tërthortë, ka zërin e tij dhe ndikon në vendimet që mësuesi merr në lidhje me mësimdhënien.

Monitorimi dhe përmirësimi:

Zhvillimi i kuiceve online, si ato në Kahoot, mundëson edhe krijimin e një baze të dhënash të vlefshme, lehtësisht të aksesueshme. Si e tillë, kjo bazë të dhënash që zgjerohet vazhdimisht, shërben në duart e mësuesit si instrument që ndihmon në monitorimin dhe deshifrimin e progresit të nxënësve, duke kontribuar në formësimin dhe përshtatjen e strategjive bazë të mësimdhënies.



Vlerësimi përmbledhës nëpërmjet platformës

Alma Koçi, shkolla e mesme profesionale “Ali Myftiu”



Vlerësimi përmbledhës apo përfundimtar përfaqëson një proces kompleks vlerësimi, i cili në thelb synon të matë arritjet e nxënësve në fund të një periudhe apo faze mësimdhënieje dhe të nxëni, duke e krahasuar nivelin me standarde apo njësi të përcaktuara vlerësimi, si për shembull një notë apo total pikësh. Ndryshe nga vlerësimi i vazhduar, në të cilin mësuesi ka shumë më tepër fleksibilitet në raport me momentin e realizimit apo formatin në të cilin e zhvillon, vlerësimi përmbledhës është më i kornizuar. Për këtë arsye, edhe transferimi i tij në një format digjital, veçanërisht në kushtet kur një nismë e tillë përbën risi në një institucion arsimor, është më sfidues, pasi kërkon strukturim dhe organizim më të kujdesshëm. Po ashtu, shkalla e përgjegjësisë së mësuesit është më e madhe. Megjithatë, ashtu si edhe vlerësimi i vazhduar, edhe ai përmbledhës, mund të realizohet online me sukses të plotë, duke përfituar nga të gjitha benefitet e këtij modaliteti.

Në shkollën e mesme profesionale “Ali Myftiu”, Elbasan, mësuese Alma Koçi, e angazhuar në drejtimin “Elektroteknikë”, ka marrë përsipër të zhvillojë provimet e Nivelit I të këtij drejtimi, duke përdorur platformën mësimore digjitale MësoVET. Për mësuesen, ka qenë një eksperiencë sfiduese, por njëkohësisht shpërblyese, falë së cilës ka arritur të aftësohet në përdorimin e mjediseve të tilla virtuale në të mirë të procesit të vlerësimit dhe të atij mësimor në tërësi, si dhe të menaxhojë në mënyrë më efektive dhe eficiente procesin e testimit të njohurive të nivelit.

HEZITIMI QË SHOQËRON ÇDO INOVACION

Të marrësh përsipër zhvillimin e një provimi niveli në një platformë mësimore digjitale nuk është aspak e thjeshtë. Përgjegjësia e lartë në mënyrën e menaxhimit të situatës para, gjatë dhe pas realizimit të provimit, ashtu si edhe mungesa e përvojës në prurjen e testit në trajtë digjitale, lindi te mësuese Alma një sërë pyetjesh: *“A do të arrij t’i përshtat siç duhet pyetjet në test me specifikat e platformës? A do të mundem ta menaxhoj situatën në klasë gjatë zhvillimit të testimit? Sa e aftë do të jem të asistoj nxënësit e mi në këtë modalitet të ri? Ç’të papritura mund të më ndodhin dhe a do të di t’i tejkaloj? Po sikur e gjitha kjo të mos funksionojë?”*. Në tërësi, një dozë e tillë hezitimi dhe skepticizmi, është mëse e kuptueshme dhe e zakonshme sa herë bëhet fjalë për të integruar qasje të reja në procesin e të nxënësve dhe të vlerësimit. E nxitur nga dëshira për ta bërë më efikas testimin në kuadër të certifikimit mbi nivelin dhe për t’i ekspozuar nxënësit me risi të tilla edhe në procesin e vlerësimit, si dhe duke gjetur mbështetjen nga kolegët e saj për asistimin që do t’i jepnin përgjatë gjithë procesit, mësuese Alma vendosi të marrë përsipër zhvillimin e provimit nëpërmjet platformës.

KONCEPTIMI I TESTIT: NGA FORMULIMI I PYETJEVE NË GJETJEN E FORMËS MË TË PËRSHTATSHME TË DIGJITIZIMIT

Konceptimi i testit të provimit të nivelit në formatin tradicional “me laps e letër” është një procedurë e përvitshme për mësuesit e shkollave profesionale. Mësuesit hartojnë testin bazuar në udhëzimet përkatëse, në përputhje me standardet e vendosura të vlerësimit. Dinamika është krejt ndryshe kur bëhet fjalë për modalitetin virtual të zhvillimit të testit. Në këtë rast, krahas formulimit të zakonshëm të pyetjeve, mësuesi, në mendjen e tij, duhet ta projektojë testin në platformë, çka nënkupton një parapërgatitje më specifike, për të përzgjedhur, strukturuar dhe kombinuar pyetjet në përputhje me paraqitjen digjitale optimale të tyre. Për mësuese Almën, kjo ishte një përvojë e re, e bazuar në konsultime të vazhdueshme me ekipin e digjitzimit pranë projektit “Aftësi për Punë”, për të sjellë në mënyrë sa më efektive përmbajtjen e testit nëpërmjet mjedisit virtual të përdorur.

Larmia e funksionaliteteve të platformës lejon strukturimin e një morie formash të pyetjeve. Mësuese Alma e shfrytëzoi këtë avantazh, duke integruar në test një gamë të gjerë pyetjesh. Pjesa më e madhe konsistonte në pyetje të mbyllura, të tilla si ato me

alternativa, me kombinim elementesh dhe me plotësim të vendeve bosh, ku përgjigja jepet nga nxënësi nëpërmjet klikimit, çiftimit të duhur apo vendosjes së fjalës kyçe të munguar. Një pjesë e këtyre pyetjeve, falë lehtësive që krijon platforma, përfshin edhe imazhe, duke e bërë më komplekse tezën e provimit. Për të mundësuar mbulimin e më shumë niveleve të arritjes së objektivave, në test u përfshinë edhe pyetje me përgjigje të hapur, të cilat plotësohen nga nxënësit me fjalët e tyre.

Procesi i korrespondimit të pyetjes me funksionalitetin e përdorur në platformë nuk ka qenë i njëkrahshëm. Mësuese Alma, së bashku me personin përgjegjës për digjitizimin e testit, kanë qëndruar në komunikim të vazhdueshëm, duke u konsultuar gjatë identifikimit të mënyrës më të mirë të paraqitjes së pyetjeve. Ky shkëmbim ka ndodhur duke patur në mendje disa aspekte kryesore:

- përshtatjen e llojit të pyetjes me aftësitë që kërkohen të demonstrohen nga ana e nxënësit;
- lehtësinë e plotësimit të pyetjes nëpërmjet ndërveprimit nxënës-platformë;
- mundësimin e një procesi korrigjimi më të shpejtë dhe sigurisht të saktë.

Pas dakordësimit mbi mënyrën e kompozimit të testit, puna vijoi me digjitizimin e pyetjeve në platformën MësoVET nga ana e ekspertit të angazhuar, si dhe me validimin e produktit digjital nga ana e mësuese Almës.

PARAPËRGATITJA PËR ZHVILLIMIN E PROVIMIT TË NIVELIT NËPËRMJET PLATFORMËS MËSOVET

Të zhvillosh një provim përmbyllës online, do të thotë të garantosh plotësimin e një sërë kushteve të infrastrukturës fizike dhe digjitale. Mësuese Alma pohon se kjo kërkon marrjen e masave nga vetë institucioni dhe nga mësuesi asistues, për t'u siguruar që gjithçka të shkojë me sukses. Por ç'duhet të zotërohet për të realizuar provimin në këtë modalitet? Mësuesja shprehet se vënia në jetë e kësaj nisme kërkon në radhë të parë **akses të plotë të nxënësve në platformë** për të plotësuar tezën e provimit. Për këtë, nevojitet paraprakisht që nxënësit të zotërojnë kredencialet e tyre për t'u loguar në platformë. Në këtë pikë të punës përgatitore, mësuese Alma u asistua nga një ekspert digjitizimi, i cili e shoqëroi edhe në hapat vijues. Po ashtu, një tjetër rekuizitë për realizimin e provimit me anë të platformës, është edhe linja e qëndrueshme e

internetit, e aftë të suportojë ngarkesën që krijohet nga fluksi i përdoruesve. Sipas mësuese Almës, ky ishte edhe një ndër shqetësimet kryesore të saj përgjatë kohëzgjatjes së provimit. Natyrisht, krahas testit digjital të ngarkuar, aksesit në platformë dhe lidhjes së vazhduar me internetin, për realizimin e provimit online është e domosdoshme edhe **pajisja e sallës me kompjutera apo laptopë funksionalë**, numri i të cilëve duhet t'i korrespondojë numrit të nxënësve të klasës. Në rastin konkret, për provimin e nivelit u shfrytëzua laborator i TIK, i cili ofronte kushte optimale.

Por, teksa liston elementet që duhet të merren në konsideratë gjatë parapërgatitjes për provimin online, mësuese Alma nuk ndalet vetëm në infrastrukturën fizike dhe digjitale. *"Thelbësore është edhe puna që vetë ne si mësues duhet të realizojmë për t'u familjarizuar me përdorimin e platformës dhe më konkretisht, me tezën e provimit, për të qenë në gjendje të asistojmë nxënësit për çdo paqartësi që ata mund të kenë gjatë procesit"*. Në të njëjtën kohë, mësuese Alma thekson edhe domosdoshmërinë e vënies në dijeni dhe **aftësimin paraprak të nxënësve për të mundësuar kryerjen me sukses të provimit**. Për këtë qëllim, mësuesja ka realizuar edhe disa seanca paraprake me nxënësit për të dhënë orientimet dhe udhëzimet e nevojshme.

REALIZIMI I PROVIMIT TË NIVELIT NËPËRMJET PLATFORMËS DIGJITALE MËSOVET

Provimi i nivelit nëpërmjet platformës MësoVET u realizua me praninë e mësuese Almës, si dhe me asistimin e mësuesit të TIK dhe ekspertit të digjitizimit, të cilët qëndruan në dispozicion të mësueses dhe të nxënësve në rast problemesh apo vështirësish teknike. Pak para fillimit të provimit online, mësuese Alma dha udhëzime të qarta për rregullat e përgjithshme të provimit, të ndjekura nga specifikat e zhvillimit të tij nëpërmjet platformës. Në përputhje me orarin e caktuar të provimit, nxënësit u loguan fillimisht në platformën MësoVET nëpërmjet kredencialeve personale. Më pas, filluan të zhvillojnë provimin përgjatë minutazhit të përcaktuar. Gjatë gjithë kohës, mësuese Alma qëndroi në dispozicion të nxënësve, duke i udhëzuar ata sipas nevojës, në përputhje me rregulloren e zhvillimit të provimit. Siç tregon mësuesja, pavarësisht aftësive digjitale që karakterizojnë brezin e ri, nxënësit kanë nevojë për t'u ndihmuar dhe orientuar gjatë punës me platformën, veçanërisht kur ajo përdoret si instrument për vlerësimin përmbledhës, ku nxënësit gjenden nën presionin e rezultatit dhe të kohës së kufizuar.

Pavarësisht ngarkesës emocionale të shkaktuar nga kjo përvojë e re e testimit përmbledhës të nxënësve, situata u menaxhua mjaft mirë nga mësuesja, si në drejtim të respektimit të rregullave të sjelljes gjatë provimit, ashtu edhe në aspektin teknik. Pyetjet apo paqartësitë e nxënësve gjatë provimit u adresuan me radhë, në mënyrë të qetë, pa krijuar shpërnqëndrim të nxënësit e tjerë. Mësuesja pohon se, në tërësi, procesi i provimit të nivelit nëpërmjet platformës digjitale MësoVET, u krye me sukses. Nxjerrja e rezultateve të nxënësve ishte dukshëm më e thjeshtë për mësuesen, së cilës iu desh të shpenzonte kohë vetëm për korigjimin e pyetjeve të hapura, teksa të gjitha ato të mbyllura vlerësoheshin automatikisht nga platforma.

PËRFITIMET E VLERËSIMIT PËRMBLEDHËS DIGJITAL

Nga ndarja e përvojës së mësuese Almës, vlerësimi digjital përmbledhës shoqërohet me disa sfida, si: zotërimi i një infrastrukture fizike dhe digjitale të kompletuar, nevoja për udhëzime teknike, aftësimi digjital i mësuesve dhe nxënësve, mungesa e përvojës në një format të tillë të realizimit të vlerësimit apo edhe pranimi nga ana e mësuesve për të aplikuar qasje të tilla inovative. Por benefitet nga vlerësimi përmbledhës digjital e justifikojnë plotësisht përballjen me to. Sipas mësuese Almës, benefitet janë shumëplanëshe dhe përfshijnë shumë aktorë.

PËRFITIMET E MËSUESIT:

- » Korigjim automatik dhe nxjerrje e menjëhershme e pikëve të fituara në pyetjet e mbyllura.
- » Më pak kohë në vlerësimin e pyetjeve të hapura krahasuar me provimin në fletë fizike.
- » Kuptueshmëri e plotë e shkrimit në përgjigjet e pyetjeve të hapura.
- » Mungesë kufizimi në llojin e pyetjeve të përfshira.
- » Ulje e riskut për të kopjuar gjatë provimit.
- » Feedback i shpejtë mbi rezultatet finale.
- » Mundësi për dokumentim më efikas, duke evidentuar mangësitë e nxënësve dhe nevojat për përmirësimin e metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies.
- » Akses dhe shkarkim në çdo kohë i rezultateve.
- » Krahasim më i thjeshtë dhe më efektiv

i rezultateve të nxënësve mes klasave paralele apo nga njëri vit në tjetrin.

- » Pasurimi i fondit të pyetjeve dhe tezave, të cilat ruhen në platformë dhe mund të modifikohen dhe shfrytëzohen nga mësuesit në orë përgatitore për provimet e radhës apo si pjesë e vlerësimit të vazhduar të nxënësve.
- » Familjarizimi i mësuesit me mjedisin mësimor virtual, duke nxitur përdorimin edhe përgjatë orëve të mësimi.
- » Përmirësim i aftësive digjitale.

PËRFITIMET E INSTITUCIONIT ARSIMOR:

- » Orientim i institucionit drejt strategjive inovative në mësimdhënie dhe të nxënë.
- » Familjarizim i stafit pedagogjik me qasjet digjitale në procesin e vlerësimit, si premisë për t'i shtrirë edhe në procesin e përditshëm mësimor.
- » Monitorim më efikas i zhvillimit të provimit dhe i vlerësimit nga ana e drejtuesve.
- » Dokumentim nga viti në vit i procesit të vlerësimit përmbledhës në tërësinë e tij.
- » Reduktim i shpenzimeve për materiale kancelerike.
- » Aftësimi digjital i stafit pedagogjik.

PËRFITIMET E NXËNËSIT:

- » Mundësi për t'iu rikthyer përgjigjeve dhe për të bërë ndryshime përpara dorëzimit të provimit në platformë.
- » Ekspozim dhe familjarizim me përdorimin e platformës digjitale si një mjedis alternativ mësimor.
- » Shmangie e plotë e riskut të penalizimit në vlerësim për shkak të moskuptimit të shkrimit.
- » Marrje e shpejtë e rezultatit final.
- » Konsolidim i aftësive digjitale.



D.

PROMOVIMI
I GJITHË-
PËRFSHIRJES
DHE
AKSESIBILITETIT
NËPËRMJET
MATERIALEVE
MËSIMORE
DIGJITALE

Jeta jonë si shoqëri njerëzore po pëson ndryshime të shpejta. Nga njëra anë, po përjetojmë një zhvillim të vazhdueshëm dhe të shpejtë të teknologjisë, ku pajisjet po bëhen më të sofistikuar dhe programet dhe aplikacionet po avancojnë, duke na lejuar të transferojmë më shumë veprime dhe shërbime në dimensionin digjital. Po ashtu, Inteligenca Artificiale dhe Realiteti Virtual nuk janë më ato që shohim vetëm në filma. Përditshmëria dhe aktivitetet tona janë transformuar gjithashtu, duke kërkuar lëvizshmëri më të lartë, fleksibilitet më të madh në raport me kohën dhe vendin, si dhe aftësim për t'iu përshtatur tendencave të së ardhmes që aq shpejt kthehen në të tashmen tonë. Të gjitha këto transformime reflektohen në procesin mësimor, i cili vazhdimisht riformësohet. Jemi dëshmitarë, çdo ditë e më shumë, të kalimit nga kuadri tradicional i mësimdhënies brenda mureve të klasës, drejt një mjedisi mësimor më fluid, pjesërisht ose plotësisht virtual. Po ashtu, shohim se si, nga një qasje klasike e përqendruar te mësuesi, jemi orientuar drejt mësimin interaktiv me në qendër nxënësin. Metodatat e mësimdhënies dhe materialet mësimore të njëtrajtshme, po zëvendësohen hap pas hapi nga ato të larmishme, madje edhe të personalizuar, të përshtatshme për nevojat dhe preferencat e ndryshme. Modalitetet e mësimdhënies dhe të nxënies po ndryshojnë gjithashtu, duke përfshirë mësimin e kombinuar dhe mësimin në distancë. Të nxënies digjitale sot është jo vetëm një trend, por edhe një domosdoshmëri, pasi përputhet me inklinimin digjital të vetë nxënësve, duke nxitur interesin dhe angazhimin e tyre, por edhe duke i përgatitur më mirë për tregun e ri të punës.

Por, së bashku me benefitet që të nxënies digjitale dhe përmbajtja mësimore digjitale paraqesin, nuk mund të neglizhohet ndikimi që ato mund të kenë në thellimin e hendekut mes individëve dhe kategorive të ndryshme të shoqërisë nëse nuk marrin në konsideratë parimin e aksesibilitetit dhe të gjithëpërfshirjes. Këto dy aspekte janë të domodoshme në kushtet ku procesi mësimor po orientohet gjithnjë e më shumë në përdorimin e mjediseve mësimore virtuale, në përmbajtje digjitale që sa vjen e shtohet dhe diversifikohet, në navigim të pandalshëm në faqe interneti për të siguruar burime të ndryshme informacioni, si dhe në një sërë aplikacionesh, programesh, por edhe rrjetesh sociale që mbështetin mësimdhënien e të nxënies. Por si ta kuptojmë aksesueshmërinë digjitale dhe gjithëpërfshirjen digjitale? Aksesueshmëria digjitale i referohet faktit se sa e disponueshme dhe lehtësisht e përdorshme është përmbajtja digjitale nga çdo individ, pra lidhet me praktikën e krijimit të një përmbajtjeje digjitale që mund të përdoret nga të gjithë me të njëjtën shkallë kuptueshmërie dhe orientimi, pavarësisht kufizimeve, veçantive apo nevojave për përshtatje (për shembull,

individë me aftësi të kufizuara motorike apo që kanë vështirësi në dëgjim, shikim apo lexim). Gjithëpërfshirja, duke e lidhur me dimensionin digjital, është një tjetër kusht që përmbajtja digjitale dhe të nxënies digjitale duhet të plotësojë. Gjithëpërfshirja digjitale nënkupton dhënien e aksesit dhe të mundësive të barabarta, mbi baza drejtësie, të të gjithë individëve, kudo që ndodhen, pavarësisht se çfarë përfaqësojnë apo ç'përkatësi kanë. Garantimi i aksesueshmërisë dhe i gjithëpërfshirjes i shton vlerë procesit të të nxënies nëpërmjet përmbajtjes digjitale, si sinonim i vetëbesimit, përfaqësimit, pjesëmarrjes dhe dinjitetit të shtuar të nxëniesit, i cili, para së gjithash, është një individ.

Kur flasim për aksesueshmëri dhe gjithëpërfshirje në kontekstin digjital, nuk mund të pretendohet se ekziston një përmbajtje digjitale që është njëlojë e aksesueshme për këdo, pra që i përgjigjet të gjitha nevojave të mundshme. Megjithatë, ka një sërë mënyrash se si përmbajtja digjitale mund të bëhet më e aksesueshme për të gjithë ne. Individët që krijojnë të tillë përmbajtje, ku një rol të rëndësishëm luajnë edhe mësuesit, mund të kontribuojnë ndjeshëm për të rritur këtë aksesueshmëri, duke i bërë materialet mësimore digjitale, por edhe vetë procesin e të nxënies, më gjithëpërfshirës dhe, për rrjedhojë, më angazhues dhe motivues.

Aksesueshmëria dhe gjithëpërfshirja lidhet me një sërë aspektesh të përmbajtjes digjitale, ndaj të cilave mësuesit duhet të tregojnë vëmendje të veçantë:

DHËNIA E KONCEPTEVE, STRUKTURA E TEKSTIT DHE TERMINOLOGJIA E PËRDORUR:

Për të ofruar materiale mësimore digjitale më të aksesueshme, mësuesit duhet të sigurohen që të japin shpjegime të qarta të koncepteve kryesore dhe të evitojnë rastet e dykuptueshmërisë.

Gjithashtu, mësuesit duhet të përdorin një gjuhë të thjeshtë, me stil të drejtpërdrejtë, si dhe të shkruajnë me fjali të shkurtura, me strukturë të thjeshtë.

Fjalori i përdorur nuk duhet të mbështetet në zhargon, por në gjuhë dhe terma standardë. Po ashtu, për një qasje gjithëpërfshirëse, duhet treguar kujdes në përdorimin e termave të veçantë që i referohen karakteristikave të ndryshme socio-demografike, duke evituar në çdo rast fjali diskriminuese, fyese dhe që nxitin ndasitë.

ELEMENTET VIZUALE:

Madhësia dhe lloji i shkrimit të përdorur, ngjyrat e përzgjedhura, si dhe videot, imazhet apo ikonat, janë po ashtu thelbësore kur flitet për garantim të aksesueshmërisë dhe të gjithëpërfshirjes në përmbajtjen digjitale. Ato duhet të zgjidhen në mënyrë të kujdesshme, duke menduar se, në jo pak raste, mund të na mungojë informacioni i duhur mbi specifikat e një apo disa prej nxënësve tanë, si përsa i takon nevojave të tij, ashtu edhe asaj që përfaqëson.

Për t'i bërë materialet mësimore digjitale sa më të përshtatshme për të gjithë, çdo mësues duhet të përdorë shkrim të përshtatshëm, lehtësisht të deshifrueshëm. Helvetica, Arial, Verdana, Tahoma, Opens Sans janë ndër më të preferuarit, pasi nuk kanë harkime shkronjash që vështirësojnë leximin, si dhe mes shkronjave të një fjale ka hapësirë të mjaftueshme për t'i dalluar nga njëra-tjetra.

Në lidhje me madhësinë e shkrimit të trupit të tekstit, përmasat nuk duhet të jenë më të vogla se 12. Këshillohet gjithashtu të evitohet shkrimi i pjerrët (Italics) dhe ai i hijëzuar.

Po aq të rëndësishme janë edhe ngjyrat e përdorura dhe veçanërisht mënyra se si kombinohen. Në rastin e sfondit të tekstit, mësuesit duhet të jenë të kujdesshëm të përzgjedhin një ngjyrë që kontraston me atë e tekstit, në mënyrë që shkrimi të jetë lehtësisht i lexueshëm.

Një tjetër element i rëndësishëm ka të bëjë edhe me përzgjedhjen e imazheve dhe ikonave, të cilat duhet t'i përshtaten kuptimit të konceptit, dukurisë apo procesit që shpjegohet. Një mënyrë shumë efektive që rrit aksesueshmërinë në lidhje me imazhet e përdorura në përmbajtjen digjitale, është përshtatimi i imazhit nëpërmjet opsionit ALT text, i cili lehtëson ndjeshëm procesin e të kuptuarit dhe të interpretuarit të imazhit.

Në të njëjtën kohë, aksesueshmëria dhe gjithëpërfshirja digjitale lidhen edhe me dhënien e mundësive të barabarta të nxënësve për të përdorur pajisje digjitale, të cilat mundësojnë punën e tyre me përmbajtjen digjitale dhe zhvillimin e formave inovatore, të kombinuara ose online, të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Në vijim, do të njihemi me rastet interesante të dy mësuesëve të shkollave profesionale "Kristo Isak", Berat, dhe "Tregtare" Vlorë, të cilat kanë ndajné përvojën dhe zgjidhjet që kanë aplikuar në mësimdhënien dhe të nxënësve digjital për të rritur aksesueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve.

Realizimi i një materiali mësimor digjital gjithëpërfshirës

Nertila Dundo, shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”



Angazhimi në dizenjimin e materialeve mësimore digjitale është sfidues për çdo mësues, pavarësisht aftësive të tij apo përvojës që mund të ketë. Përputhja e përmbajtjes mësimore digjitale me rezultatet e të nxënësve, ideimi i veprimtarive mësimore të ndërtuara mbi bazën e materialit digjital, përzgjedhja e instrumenteve të matjes së njohurive apo përshtatja e materialit për ta bërë sa më angazhues, kërkon kohë dhe impenjim nga mësuesi. Por, puna për përgatitjen e një materiali mësimor digjital është edhe më komplekse se kaq. Gjatë konceptimit dhe paraqitjes në platformë, mësuesi duhet të garantojë se materiali i përmbahet parimeve të aksesueshmërisë dhe të gjithëpërfshirjes digjitale. Nuk janë të pakta rastet kur mësuesit e neglizhojnë këtë aspekt të përmbajtjes digjitale mësimore, i cili në të vërtetë është parësor për një edukim të barabartë dhe të drejtë, ku askush nuk ndihet i përjashtuar. Në shkollën e mesme profesionale “Kristo Isak” në Berat, mësuese Nertila, hartuese dhe njëkohësisht pjesëmarrëse në digjitizimin e materialeve mësimore të lëndëve që mbulon, është veçanërisht e ndjeshme ndaj këtyre aspekteve. E motivuar edhe nga prania e disa nxënësve të komunitetit rom në klasat ku zhvillon mësim, ajo përpiqet të prodhojë materiale mësimore digjitale sa më gjithëpërfshirëse, si dhe qëndron vazhdimisht e përditësuar mbi të rejtat në këtë fushë, për t'i pasqyruar më pas në materialet e saj.

KONCEPTIMI I MATERIALIT MËSIMOR NËN OPTIKËN E GJITHËPËRFSHIRJES

Gjatë ndarjes së përvojës së saj, mësuese Nertila shprehet se përpjekjet për të sjellë një produkt digjital sa më të aksesueshëm nga të gjithë dhe sa më gjithëpërfshirës, duhet të shoqërojnë të gjithë hapat e krijimit të materialit mësimor digjital. Gjithçka nis nga burimet që mësuesja konsulton për të plotësuar dhe përditësuar përmbajtjen mësimore, duke treguar vëmendje të veçantë në besueshmërinë e informacionit. Siç thotë mësuesja: *“Burimet që ofrohen nga ekspertë të fushës dhe kanë kaluar në filtra rishikimi, janë më të preferueshme për t’u konsideruar gjatë përgatitjes së materialit mësimor digjital, pasi kanë natyrë më gjithëpërfshirëse në mënyrën e të shkruarit”*. Po ashtu, rëndësi të veçantë në garantimin e kësaj qasjeje, ka edhe mënyra e organizimit të komponentëve të përmbajtjes mësimore. Iidetë, faktet, proceset, dukuritë, shembujt dhe çdo element tjetër, duhet të strukturohen dhe të ndërthuren në mënyrë të tillë që materiali të vijë në formë sa më të qartë, për të qenë i kuptueshëm dhe i përvetësueshëm nga të gjithë nxënësit. Ruajtja e linjës logjike, së bashku me konsistencën e ideve që shprehen, të çon drejt një materiali kohorent, që i shërben transferimit efikas të dijeve. Në funksion të rritjes së nivelit të kuptueshmërisë së materialit, mësuese Nertila thekson rëndësinë e shoqërimit të koncepteve kyçe me shembuj konkretë apo me situata që i referohen përditshmërisë së nxënësve. Stili i të shkruarit është po

aq i rëndësishëm. Sipas mësueses: *“Fjalitë nuk duhet të jenë as tejet të shkurtra, pasi rrezikojnë të mos shprehin asgjë, por as shumë të gjata, pasi për nxënësit me aftësi kognitive jo aq solide, mund të krijojnë vështirësi në të kuptuarit e tyre. Idealisht, duhet të jenë aq të shkurtra sa ende të ruajnë thelbin e kuptimit të tyre”*. Por më tepër se sa çështje e qartësisë në të shkruar apo e gjetësisë së fjalive, gjithëpërfshirja për mësuese Nertilën lidhet me përdorimin e një gjuhe të matur dhe empatike, që jo vetëm nuk diskriminon apo fyen mbi baza aftësish apo përkatësisë, por përpiqet të jetë sa më integruese dhe përfaqësuese e nevojave dhe diversitetit që ekziston mes nesh.

ZBATIMI I PARIMEVE TË AKSESUESHMËRISË DHE TË GJITHËPËRFSHIRJES GJATË DIGJITIZIMIT TË MATERIALIT MËSIMOR

Një material mësimor digjital nuk mund të konsiderohet gjithëpërfshirës nëse ky tipar nuk e shoqëron edhe gjatë fazës së digjitizimit. Siç shpjegon mësuese Nertila, teksti i përgatitur për materialin mësimor digjital është shumë ndryshe nga produkti final i digjitizuar, pasi gjatë punës në platformë, bëhen një sërë përshtatjesh, modifikimesh apo kalimesh në formate të tjera vizualizimi, si për shembull, krijimi i një prezantimi mbi bazën e materialit të shkruar apo shoqërimi i kuicidit edhe me imazhe në vend të

opsioneve të shprehura me fjalë. Për rrjedhojë, materiali mësimor digjital, i pasuruar edhe me përmbajtje të re digjitale (si p.sh. forume, video, lojëra), vjen në një mënyrë më komplekse, duke përfshirë një sërë formatesh për përcjelljen e informacionit të ri, dhënien e udhëzimeve, matjen e nivelit të njohurive apo thjesht rritjen e angazhimit të nxënësve. Nisur nga kjo larmi, mësuese Nertila thekson rëndësinë e aplikimit të parimeve bazë të aksesueshmërisë dhe të gjithëpërfshirjes përgjatë gjithë materialit mësimor digjital. Por si vepron mësuesja për këtë qëllim? Ndaj cilave elemente tregon më tepër kujdes?

Siç pohon ajo vetë, *“Gjithçka varet së pari nga mënyra se si pjesë të caktuara të materialit do të ofrohen. Nëse do të ketë më shumë tekst, përpiqem ta sjell në mënyrë sa më konçize. Nëse realizoj edhe një prezantim mbështetës në PowerPoint apo në një tjetër program, fokusohem edhe te përzgjedhja e ngjyrave dhe imazheve”*. Kështu, mësuesja, aty ku është e mundur, përdor shpesh pikat (bullet points) për të zëvendësuar tekstet dhe paragrafët tejet të gjatë. Për një konkretizim më të mirë, që përkthehet në kuptueshmëri më të lartë, pjesë të caktuara të tekstit apo koncepte të veçanta i shoqëron edhe me imazhe të ndryshme, si: foto, skica, grafikë etj. Përzgjedhja e imazheve realizohet po ashtu në mënyrë të kujdesshme, duke përdorur vetëm ato me rezolucion të lartë, si dhe ato që paraqesin qartë procesin, dukurinë apo idenë qendrore. Këto elemente mbahen në konsideratë edhe gjatë realizimit të prezantimeve të ndryshme. Njëkohësisht, në prezantime të tilla mësuesja tregohen vëmendje për siguruar kontrast të mjaftfueshëm ngjyrash mes shkrimit dhe sfondit të prezantimit, ashtu si edhe mes imazheve të përdorura dhe sfondit. Në këtë mënyrë, mësuesja e bën materialin më të qartë për t'u kuptuar nga të gjithë dhe adreson veçanërisht edhe specifikat e nxënësve që mund të kenë vështirësi në shikim apo të atyre daltonikë. Po këto parime, mësuesja i aplikon edhe kur krijon apo editon një imazh. Krahas këtyre aspekteve me natyrë teknike, vëmendje të veçantë merr përmbajtja e imazheve apo videove që mësuesja integron në materialin mësimor digjital, duke shmangur ato që nxitin diskriminimin. Në varësi të tematikës, mësuesja u jep përparësi imazheve që përcjellin mesazhe gjithëpërfshirëse në raport me opsionet e tjera.

“Nëse, për shembull, dëshiroj të integroj në material një imazh mbi punën në grup, preferoj të përzgjedh një foto me individë të racave apo etnive të ndryshme apo një foto ku të gjendet edhe një individ me aftësi të kufizuara të lëvizjes. Në këtë mënyrë, cilido nxënës që njihet me materialin, do të ndihet i përfaqësuar dhe do të marrë edhe një mesazh të qartë mbi gjithëpërfshirjen”.

DISA KËSHILLA PËR T’U KONSIDERUAR

Falë eksperiencës së fituar, mësuese Nertila tashmë ndihet e familjarizuar me mënyrën se si duhet të ofrohet një material mësimor digjital, ndaj ajo ndan disa këshilla që mund të merren në konsideratë nga mësues që hartojnë përmbajtje digjitale.

1. Mos përdorni terma të ndërlikuar për t'u kuptuar, por përpiquni të flitni me fjalë të thjeshta! Nëse në disa raste, është e pashmangshme të evitohen terma të tillë, si për shembull në rastin e emërtimeve standarde apo koncepteve kyçe, mund ta shoqëroni fjalën me një shpjegim të thejstuar ose të integroni në material një fjalorth, siç e mundëson edhe platforma MësoVET.
2. Pasi të përfundoni së shkruari tekstin e materialit, lexojeni edhe njëherë për të kuptuar nëse duhet të hiqni, të shtoni apo të përmirësoni diçka! Mund të identifikoni fjali tepër të gjata e të ndërlikura apo fjalë që tingëllojnë të papërshtatshme në kontekste të caktuara.
3. Tregoni kujdes të veçantë nëse prekni tematika dhe çështje sensitive, si ato të lidhura me aftësitë ndryshe, përkatësinë etnike apo racore, bindjet fetare apo politike!
4. Rikthejuni materialit mësimor edhe pas digjitzimit të tij! Shihni me vëmendje mënyrën e konfigurimit të tij për të kuptuar se sa e thjeshtë është të orientohesh! Tregoni vëmendje edhe ndaj madhësisë së tekstit, qartësisë së imazheve dhe lehtësisë në kalimin nga një rubrikë apo veprimtari në tjetrën!
5. Validojeni materialin digjital me një koleg apo edhe një nxënës! Porositeni që ta shohë me kujdes, në lidhje me koherencën e përmbajtjes, mënyrën e konfigurimit në platformë, qartësinë e udhëzimeve, gjuhën dhe imazhet e përdorura! Më pas konsultohuni me të për të kuptuar se ç'mund të përmirësoni!
6. E fundit, dhe ndoshta më e rëndësishmja, mbani gjatë gjithë kohës parasysh se materiali mësimor digjital i krijuar prej jush, ka një rreze të gjerë impakti, pasi mund të përdoret nga shumë klasa dhe shkolla të tjera, me nxënës me nevoja dhe specifika nga më të ndryshmet! Si rrjedhojë, kujdesi për ta bërë sa më të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës duhet të jetë maksimal.

Nisma “Sill pajisjen tënde” (Bring Your Own Device)

▶ Meralda Mahilaj, shkolla Tregtare Vlorë



Përdorimi i teknologjisë në arsimin profesional është bërë gjithnjë e më i përhapur vitet e fundit, me shumë shkolla që e përfshijnë atë tashmë në kurrikulën e tyre dhe aktivitetet në klasë. Por jo të gjitha klasat mund të kenë infrastrukturën e duhur që të aplikohen me sukses këto mënyra të reja mësimdhënjeje, ku teknologjia është facilituesja kryesore. Për këtë arsye, një qasje që kohët e fundit ka fituar popullaritet në mbarë botën është “Sill pajisjen tënde” (Bring Your Own Device), e cila inkurajon nxënësit të sjellin në shkollë pajisjet e tyre personale, të tilla si aparatë celularë, tableta, laptopë, për t’i përdorur në klasë gjatë orës mësimore. Nga njëra anë, kjo nismë ka potencialin të përmirësojë përvojën e të nxënësve, duke u ofruar nxënësve më shumë mundësi për të ndërvepruar me platforma të ndryshme digjitale dhe për të aksesuar materialet mësimore digjitale. Nga ana tjetër, i lejon mësimdhënësve të planifikojnë orë mësimore më interaktive dhe të personalizuara, duke përdorur në avantazhin e tyre aplikacionet dhe mjetet digjitale të disponueshme për edukim. Ajo çfarë e bën këtë qasje të veçantë nga të tjerat, është fakti se ndihmon për të kapërcyer ndarjen digjitale, pasi nxënës që mund të jenë më pak të privilegjuar se të tjerët, mund të mos kenë akses në të njëjtat pajisje teknologjike si bashkëmohatarët e tyre.

Zbatimi i nismës “Sill pajisjen tënde” në një mjedis shkollor është sfidues, pasi kërkon një planifikim të mirë dhe përgatitje për të siguruar mbarëvatjen e orës mësimore, ku nxënësit përdorin në mënyrë të përgjegjshme pajisjet e tyre personale. Megjithatë Meralda Mahilaj, mësuese pranë shkollës ‘Tregtare’ Vlorë, ka arritur ta implementojë këtë qasje me sukses, duke nxjerrë në pah përfitimet dhe sfidat e kësaj zgjidhjeje dhe duke ofruar rekomandime për shkollat e tjera të interesuara për zbatimin e saj.

NJË ORË MËSIMORE “AVANGARD”: HAPAT QË DUHEN NDJEKUR NGA PËRGATITJA TEK IMPLEMENTIMI

Duke dashur të sjellë një orë mësimore “avangarde” dhe dinamike, nëpërmjet aplikimit të metodologjive të reja në mësimdhënie dhe të nxënësve, në mungesë të mundësisë për të përdorur laboratorin e TIK në shkollë, mësuese Meralda përqafoi nismën “Sill pajisjen tënde” dhe filloi të ekperimentojë aplikimin e saj në ato ore mësimore që ajo i konsideronte të përshtatshme për këtë qasje. Tashmë që zbatimi i kësaj qasjeje me nxënësit është bërë më i shpeshtë, mësuesja ka arritur të konsolidojë aplikimin e mirëfilltë të saj dhe të ndërgjegjësohet mbi hapat që duhet të ndjekë, si në procesin e planifikimit ashtu edhe gjatë implementimit.

1 Hapi i parë në përgatitjen për një qasje të tillë është përpilimi i instruksioneve dhe rregullave që do t’u komunikohet nxënësve në lidhje me përdorimin e pajisjeve personale digjitale në klasë. Ajo duhet të përfshijë udhëzime se ku dhe si është

i pranueshëm dhe i ndaluar përdorimi i tyre, si dhe të përmendë pasojat për rastet kur ato përdoren për qëllime jashtë kontekstit të orës mësimore. Mësuese Meralda sugjeron që këto instruksione të printohen e të vendosen në klasë në një format A4.

2 Familjarizimi i nxënësve me platformat që do të përdorin dhe si do t’i përdorin ato përpara se të aplikohet kjo nismë është shumë e rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin e nxënësit, si dhe për ta bërë orën më efektive gjatë zbatimit të nismës.

3 Nga ana tjetër, është i nevojshëm familjarizimi nga ana e mësueses me përdorimin e llojeve të ndryshme të pajisjeve që mund të sjellin nxënësit. Në këtë mënyrë ata mund t’i asistojnë ata në rast vështirësie, si për shembull, gjatë lidhjes me internetin, gjatë përdorimit të aplikacioneve, etj.

4

Një hap tjetër thelbësor gjatë përgatitjes, është të sigurohemi se klasa ka një linjë interneti mjatueshëm të fuqishme për të mbuluar lidhjen e të gjitha pajisjeve njëkohësisht dhe për të përdorur pa vështirësi platformat e ndryshme digjitale.

5

Pjesë e fazës përgatitore është edhe planifikimi i orës mësimore dhe aktiviteteve në mënyrë të tillë që puna me pajisjet digjitale të ketë impaktin e dëshiruar nëpërmjet përdorimit të platformave për edukim dhe burimeve online të informacionit. Për mësuese Meraldën, procesi përgatitor në këtë aspekt është lehtësuar në sajë të mënyrës se si janë hartuar materialet mësimore të disponueshme në platformën MësoVET dhe të funksionaliteteve që platforma ofron.

6

Për aplikimin e kësaj nisme, është thelbësore të jesh i përgatitur për t'u përshtatur me nevojat e nxënësve dhe të njihesh me aplikacionet dhe burimet e ndryshme që mund të përdoren me ta për të përmirësuar të nxënët dhe rritur angazhimin e tyre.

7

Gjitashtu, mësuesit duhet të kenë një plan B në rastet kur procesi nuk shkon siç ishte parashikuar. Për shembull, në rastet kur disa pajisje personale nuk punojnë ose kur interneti nuk mbulon dot përdorimin e njëkohshëm të tyre, nxënësit mund të vendosen të kryejnë aktivitetet në grup (me anë të një pajisjeje të vetme), të mundësojmë një linjë alternative interneti (hotspot) ose të zëvendësojmë në moment aktivitetin me diçka alternative.

8

Në fillim të orës, mësuesja u jep nxënësve intruksionet dhe shpjegimet e nevojshme për veprimtaritë mësimore të parashikuara.

9

Gjatë fazës së implementimit, mësuesja monitoron rregullisht përdorimin e pajisjeve personale në klasë për t'u siguruar që ato po përdoren siç duhet dhe që nxënësit janë duke ndjekur detyrën që u është përcaktuar. Përdorimi i platformave si MësoVET, Kahoot, Google Drive, etj., u krijon mësuesve mundësinë të shohin nëse nxënësit i kanë aksesuar ato dhe nëse vazhdojnë të jenë të angazhuar online.

10

Përgjatë kryerjes së aktiviteteve, mësuesja luan rol mbështetës, duke i asistuar si në planin pedagogjik, ashtu edhe në atë teknik.

NDIHENI TË DYZUAR? – ANALIZA SWOT PËR NJË TABLO TË QARTË APLIKIMI TË NISMËS “SILL PAJISJEN TËNDE”

Aplikimi i nismës “Sill pajisjen tënde” ka qenë i frytshëm si për mësuese Meraldën, ashtu edhe për nxënësit e saj. Nëpërmjet kësaj qasjeje, është bërë i mundur planifikimi i një ore mësimore më të personalizuar, ku ndërveprimi dhe fleksibiliteti është i lartë. Rezultati: një performancë më e mirë nga ana e nxënësve. Edhe pse janë hasur pengesa nga më të ndryshmet gjatë këtij rrugëtimi, mësuesja është munduar të jetë fleksibël, t'i adresojë dhe të gjejë një zgjidhje për to në vend që të heq dorë. Duke marrë në konsideratë që, mësuesve që dëshirojnë të aplikojnë këtë qasje për herë të parë, do t'u duhet të kalojnë një rrugëtim të ngjashëm, së bashku me mësuese Meraldën sjellim një reflektim në formën e analizës SWOT për të parashtruar pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet që sjell realizimi i një ore mësimore sipas kësaj nisme.

PIKAT E FORTA

- Prania e përmbajtjes digjitale, lehtësisht e aksesueshme nga burime të ndryshme;
- Askesi i shkollës në linjë Wi-Fi;
- Aftësitë e kënaqshme digjitale të nxënësve për të përdorur lehtësisht pajisjet;
- Orientimi i edukimit drejt metodave dhe teknikave mësimore inovative;
- Ndërgjegjësimi mbi vlerën e shtuar të përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe të nxënë.

DOBËSITË

- Mbulimi i kufizuar i linjës Wi-Fi;
- Infrastruktura fizike dhe digjitale jo e plotë;
- Aftësitë digjitale të pamjaftueshme të mësuesit;
- Mungesa e përvojës së mësuesit në aplikimin e mësimdhënies së mbështetur në teknologji;
- Pozicionimi i vështirë i mësuesit në rolin e facilituesit.

MUNDËSITË

- Mundëson përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar përvojën e mësimdhënies dhe të të nxënësit;
- Lejon më shumë fleksibilitet si në planifikimin e aktiviteteve, ashtu edhe në mënyrëm se si ato realizohen në klasë;
- U krijon mësuesve mundësinë të japin komente (feedback) online në detyrat e shtëpisë, kuize dhe provime;
- Përmirëson kompetencat digjitale të nxënësve dhe mësuesve;
- Promovon kulturën e bashkëpunimit dhe solidaritetit në kontekstin e edukimit.

KËRCËNIMET:

- Problemet e mundshme teknike gjatë aplikimit të qasjes;
- Kostoja e lartë e investimeve në teknologjinë dhe infrastrukturën e nevojshme, si dhe në mirëmbajten e tyre;
- Cënimi nga sulmet kibernetike, viruset dhe kërcënimet e tjera të sigurisë;
- Rreziku që nxënësit të aksesojnë përmbajtje të papërshtatshme në internet;
- Rreziku që nxënësit të humbasin ose dëmtojnë pajisjet e tyre.

Në përgjithësi, nisma “Sill pajisjen tënde” në shkollën “Tregtare” është një shembull i mirë se si teknologjia mund të përdoret për të përmirësuar përvojën e të nxënësit, duke promovuar gjithashtu gjithëpërfshirjen, diversitetin dhe aksesibilitetin. Shkollat e tjera të interesuara për zbatimin e një qasje të ngjashme mund të mësojnë nga sukseset dhe sfidat në shkollën “Tregtare” dhe t’i përdorin ato si një udhëzues për të implementuar një qasje që funksionon me nxënësit dhe komunitetin e tyre.

Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i kësaj nisme mund të ndryshojë nga shkolla në shkollë dhe duhet t’i përshtatet nevojave dhe burimeve specifike të shkollës. Megjithatë, nëse fokusi vendoset te gjithëpërfshirja, diversiteti dhe aksesibiliteti, shkollat mund të gjejnë format e duhura dhe të arrijnë që nxënësit të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga përdorimi i teknologjisë në edukim dhe të jenë të suksesshëm në epokën dixhitale.





E. KAPILARIZIMI
I PROCESIT
MËSIMOR
ME BAZË
TEKNOLOGJINË

Integrimi i teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve ka revolucionarizuar mënyrën se si edukimi transmetohet. Ky transformim ka përfshirë jo vetëm nxënësit dhe mësuesit, por edhe liderhipin në shkollë dhe prindërit, të gjithë duke punuar së bashku për të krijuar një mjedis të nxënësve më efikas. Me përdorimin e mjeteve dhe burimeve digjitale, nxënësit tani janë në gjendje të angazhohen me përmbajtje mësimore në mënyra të reja, duke iu përshtatur mjediseve ku ata dëshirojnë të ndërveprojnë, ndërsa mësuesit janë në gjendje të personalizojnë mënyrën se si ofrojnë edukimin, në përgjigje të nevojave të secilit nxënës. Ndërkohë, personat e angazhuar në role menaxhuese brenda institucionit arsimor, përdorin teknologjinë për të marrë vendime të bazuara në të dhëna, ndërsa prindërit mbështetin dhe krijojnë kushtet e duhura për përdorimin e teknologjisë në ambientet e shtëpisë. Për realizimin me sukses të një procesi mësimor me bazë teknologjinë, nevojitet bashkëpunimi mes këtyre aktorëve kryesorë; nëse njëri nga këto elemente nuk do të përfshihej në vizionin e përbashkët, ky vizion do të binte. Përdorimi i teknologjisë në avantazh të procesit mësimor duhet të konsiderohet si një qasje drejt zhvillimit të të gjithë institucionit dhe aktorëve të përfshirë në të. Fryma bashkëpunuese dhe kohezioni është veçanërisht i rëndësishëm kur institucioni arsimor vendos ta shndërrojë mësimin me bazë teknologjinë në strategjinë bazë të mësimdhënies dhe të të nxënësve. Secilit aktor i duhet të rikonfigurojë rolet që luan, mënyrat se si vepron dhe mendësitë e tij në këtë realitet të ri efektiv, por edhe sfidues. Për këtë arsye, shkëmbimi mes aktorëve, fleksibiliteti gjatë procesit dhe mbështetja e vazhdueshme janë thelbësore. Pjesë e mekanizmave mbështetës është edhe caktimi i rolit të 'Personi kyç i digjitalizimit' në shkollë.

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM 'PERSONI KYÇ I DIGJITALIZIMIT' NË SHKOLLË?

Roli i Personit Kyç të Digjitalizimit është mjaft i rëndësishëm në përditshmërinë e institucioneve arsimore në ditët e sotme. Në një moment kur institucionet janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme TIK, prezantimi i këtij roli i jep një dimension tjetër si përdorimit të teknologjisë, në mësimdhënie dhe në menaxhimin e institucionit, ashtu dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe asetëve TIK, duke synuar qëndrueshmërinë. Ky rol ka për qëllim të krijojë të gjitha kushtet dhe ndërlihdjet e nevojshme tek aktorët e përfshirë në mënyrë që përdorimi i teknologjisë në edukim të brendësohet nga të gjithë.

Ky pozicion, i cili më parë ndërmerrej vullnetarisht nga mësues me iniciativë dhe aftësi të mira në TIK, ka për qëllim të sigurojë përdorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, të menaxhojë dhe administrojë platformat për edukim, si platforma MësoVET, të mbështetë përdoruesit dhe t'u japë zgjidhje problematikave të ndryshme që dalin gjatë përdorimit. Personi Kyç i Digjitalizimit në shkollë mund të përfshihet lehtësisht me njohuritë që ka në asistimin e mësuesve dhe nxënësve në përdorimin e materialeve digjitale të disponueshme në platformat për edukim, ngarkimin e materialeve të reja, krijimin e kurseve, etj. Gjithashtu, ata mund të transferojnë njohuritë e tyre te mësuesit dhe nxënësit, duke i kapacituar në aspekte teknike të përdorimit të platformës MësoVET dhe jo vetëm, si dhe të infrastrukturës në përgjithësi. Të gjitha këto elemente ndihmojnë në mënyrë tërthortë në promovimin dhe implementimin e formave të reja të mësimdhënies me në qendër nxënësit në shkollat profesionale.

Gjithsesi, roli i këtij personi shkon përtej mbështetjes teknike në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe të nxënësve. Një aspekt shumë i rëndësishëm i këtij roli është maksimizimi i potencialit që platformat për edukim kanë, për të automatizuar proceset administrative dhe menaxhuese në shkollë, duke punuar ngushtë me liderhipin në shkollë drejt zhvillimit të strategjive për digjitalizimin institucional.

DISA ASPEKETE PËR T'U MARRË NË KONSIDERATË NGA PERSONI KYÇ I DIGJITALIZIMIT NË SHKOLLË:

- » **Zhvillimi i një vizioni të përbashkët të mbështetur nga një strategji për implementimin e teknologjisë në procesin mësimor dhe në menaxhimin e shkollës:** Sikurse për çdo praktikë novatore, një strategji e qartë, e cila udhëheq ndryshimin, dhe një vizion i përbashkët, janë thelbësore për t'i bërë ballë problematikave të ndeshura në rrugën drejt adaptimit me këtë qasje të re. Ky vizion i ri kërkon ndryshim në format tradicionale të të menduarit dhe të vepruarit, përgjegjësi të reja të stafi i shkollës, si dhe angazhim të madh të liderhipit në fazat e para të procesit.
- » **Transformimi i vizionit në një plan veprimi bazuar në frymën e bashkëpunimit:** Mësuesit dhe liderhipi i shkollës përjetuan një periudhë të ndryshimeve dhe novacioneve të mëdha gjatë mësimin të distancë në periudhën e

pandemisë COVID-19. Përvoja e krijuar dhe vazhdimësia e praktikave të reja sipas një plani të strukturuar dhe të mirëorganizuar, është e rëndësishme në kalimin nga një qasje tradicionale në atë inovatore. Pjesë e këtij plani duhet të jenë aktivitetet, objektivat e matshme, kohëzgjatja, personat përgjegjës, monitorimi dhe dokumentimi i procesit dhe përmirësimi i vazhdueshëm. Në këtë qasje, rol të rëndësishëm duhet të luajë edhe Personi Kyç i Digjitalizimit.

- » **Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve dhe të lidershit për të përdorur infrastrukturën në dispozicion:** Aplikimi i teknologjisë në mësimdhënie kërkon përdorimin e teknologjive digjitale dhe të infrastrukturës fizike, si dhe përvetësimin e formave të aplikimit të tyre në mësimdhënie. Për këtë arsye, suporti i vazhduar dhe mundësitë për zhvillim të vazhduar profesional të mësuesve, si dhe të lidershit, duhet të jenë pjesë integrale e strategjisë.
- » **Mbështetja e nxënësve për të nxënit online:** Edhe pse brezat e sotëm dinë të ndërveprojnë online, mund të lindë nevoja për suport për disa prej tyre. Përpos mbështetjes

që mund të gjejnë nga mësuesi në klasë, Personi Kyç i Digjitalizimit mund të organizojë seanca të posaçme për zhvillimin e aftësive digjitale të këtyre nxënësve, në kontekstin e përdorimit të platformave të ndryshme digjitale për mësimin me bazë teknologjinë. Në këtë mënyrë, ngushtohet hendeku mes nxënësve në raport me aksesin në teknologjitë digjitale.

- » **Krijimi i një komuniteti që mbështet përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie:** Edhe pse mësimdhënia me bazë teknologjinë deri më tani nuk është zbatuar në plan institucional, disa mësues e aplikojnë me sukses në përditshmërinë e tyre. Është e rëndësishme që këto raste suksesi të jenë ambasadorët e strategjisë së re në shkollë, të krijojnë komunitetin e tyre të praktikave me qëllim ndarjen e eksperiencave, të organizojnë orë të hapura apo takime formale e joformale me mësuesit e tjerë. Personi kyç i Digjitalizimit duhet të mbështetë organizimin e këtij komuniteti praktikash, i cili ndihmon në vizionin dhe frymën e përbashkët, si dhe të ndihmojë që ky komunitet të shtrihet edhe mes shkollave simotra.

Promovimi i mësimit të kombinuar nëpërmjet Digital Focal Points

Rudina Gjoka, shkolla profesionale “Kolin Gjoka”



Me rritjen e impaktit të teknologjive digjitale në jetën dhe punët që kryejmë, digjitalizimi i procesit mësimor nuk përfaqëson më një opsion. Pavarësisht lokacionit gjeografik, traditës arsimore dhe përvojës së krijuar, çdo kontekst edukativ tashmë e ka të nevojshme të orientohet drejt aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, si kusht për implementimin e një procesi të modernizuar mësimdhënieje dhe të nxëni. Në këtë suazë, përvoja botërore e pozicionon mësimin e kombinuar në krye të listës, si një qasje që ndërthur në mënyrë sinergjike të mirat e veprimtarive mësimore tradicionale ballë për ballë me ato që zhvillohen online. Natyrisht, ta shndërrosh mësimin e kombinuar në strategjinë bazë të mësimdhënies në institucionin arsimor, nuk është e thjeshtë dhe as nuk ndodh brenda ditës. Brendësimi dhe aplikimi i strukturuar e i vazhdueshëm i tij kërkon kohë, rritje kapacitetesh dhe ndryshim të mendësisë, por në veçanti, kërkon shkëmbim efektiv mes aktorëve të përfshirë, që nisma të jetë e qëndrueshme në kohë.

Në kuadër të bashkëpunimit me projektin “Aftësi për Punë”, Rudina Gjoka, mësuese pranë shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka” në Lezhë, luan prej vitit 2022, rolin e Personit Kyç të Digjitalizimit, ku krahas funksioneve bazë që ky pozicion parashikon, operon përkrah kolegëve të saj edhe si një katalizatore e mirëfilltë në aplikimin e mësimit të kombinuar.

NJË MËSUERE NË ROLIN E PERSONIT KYÇ TË DIGJITALIZIMIT

Caktimi i mësuese Rudinës në cilësinë e Personit Kyç të Digjitalizimit, si nxitës dhe asistues në integrimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe në përdorimin e platformës digjitale MësoVET nga të gjithë aktorët e shkollës, ishte një zgjedhje që erdhi krejt natyrishtë. Aftësimi i vazhdueshëm i mësuese Rudinës ishte një bazë e fortë për t'i besuar një rol të tillë. Pjesëmarrja në trajnime fizike dhe online me ekspertë vendas e të huaj, në webinar-e, programe shkëmbimi dhe takime informuese në lidhje me metodat novatore të të nxënit dhe krijimin e përmbajtjes digjitale, e ka ndihmuar mësuesen të konsolidojë aftësitë digjitale të saj dhe të ekspozohet me qasjet e reja në mësimdhënie e të nxënë. Mësuese Rudina është po ashtu një njohëse shumë e mirë e funksioneve të platformës MësoVET, e organizimit të materialeve mësimore digjitale të vendosura në të, si dhe e opsioneve të monitorimit dhe dokumentimit që ky mjedis mësimor virtual ofron. Krahas këtyre aspekteve me natyrë më teknike, ushtrimi i funksioneve që roli i Personit Kyç të Digjitalizimit parashikon, është lehtësuar edhe nga marrëdhëniet e afërta dhe pozitive që mësuese Rudina ka me kolegët e saj. Përvoja 20-vjeçare në këtë shkollë, në pozicionin e mësueses, por edhe në poste drejtuese, e ndihmon të

ketë një qasje dhe impakt më efikas në mbështetjen që siguron për të gjithë aktorët e shkollës.

PROMOVIMI I MËSIMIT TË KOMBINUAR PËRMES PERSONIT KYÇ TË DIGJITALIZIMIT

Në rolin e Personit Kyç të Digjitalizimit, mësuese Rudina ka një synim dhe vizion të qartë: mbështetjen dhe nxitjen e aktorëve të shkollës për të aplikuar mësimdhënien dhe të nxënit bashkëkohor, bazuar në përdorimin e teknologjisë dhe të strategjive moderne mësimore. Orientimi drejt mësimit të kombinuar, si bazë e veprimtarive mësimore në klasë duke implementuar teknologjinë dhe punën e pavarur të nxënësit, është në fokus të përpjekjeve të saj. E vetëdijshme se përfaqimi i një modaliteti të tillë ndodh në mënyrë graduale, mësuesja implementon një qasje komplekse dhe fleksibël në pozicionin e Personit Kyç të Digjitalizimit. Por si realizohet kjo qasjeje?

Mënyra formale dhe jo formale e ofrimit të mbështetjes:

Sipas mësuese Rudinës, çelësi i suksesit qëndron te shfrytëzimi i të gjitha hapësirave të mundshme për të dhënë mbështetje. Si mënyrat më formale, në formën e takimeve të planifikuara, ku diskutohet më gjerësisht për promovimin e mënyrave bashkëkohore të mësimdhënies,

ashtu dhe mbështetja e menjëhershme, sipas nevojës, apo edhe diskutimet spontane mes mësuesve, janë të gjitha mundësi të vlefshme për t'u shfrytëzuar.

Kontekstualizimi dhe personalizimi:

Mësuese Rudina është mëse e ndërgjegjshme se mësimi me bazë teknologjinë dhe aq më tepër ai i kombinuar, përveçse një modalitet i zhvillimit të mësimdhënies dhe të nxënies, është njëkohësisht edhe një sistem kompleks edukimi, që përfshin metoda, teknika, infrastrukturë fizike, teknologji digjitale dhe aftësi, të cilat kërkojnë përshtatje për t'u aplikuar suskesshëm në kontekste dhe instucione të ndryshme arsimore. Për rrjedhojë, mënyra se si ajo përipiqet ta nxitë integrimin e mësimin të kombinuar në procesin mësimor të shkollës së saj, është e kontekstualizuar, duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si: kushtet infrastrukturore, specifikat lëndore, aftësitë digjtale të mësuesve etj. Veçanërisht të rëndësishme në këtë aspekt, mësuese Rudina konsideron eksperiencën konkrete të mësuesve në aplikimin e mësimdhënies me bazë teknologjinë, si një tregues domethënës për nevojën për mbështetje.

TË “MËSOSH” MËSUESIT: NJË PROCES SFIDUES, POR IMPAKTUES

Një ndër përgjegjësitë kryesore të Personit Kyç të Digjitalizimit është asistimi i mësuesve dhe aktorë të tjerë të shkollës në përdorimin e teknologjive digjitale në përgjithësi dhe të platformës MësoVET në veçanti. Por, për mësuese Rudinën, ky rol duhet interpretuar në mënyrë më komplekse. Sipas saj, të jesh Personi Kyç i Digjitalizimit nuk do të thotë të presësh “duarkryq” që mësuesit apo aktorë të tjerë të shkollës të kërkojnë ndihmën tënde. Sipas mësueses, krahas asistimit në rast nevoje, po aq thelbësore është proaktiviteti, duke i stimuluar dhe orientuar vazhdimisht mësuesit që t'i referohen teknologjisë në mësimdhënie dhe të ndërthurin orën mësimore edhe me veprimtari online, me pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Në këtë mënyrë, Personi Kyç i Digjitalizimit kontribuon pikërisht në thelbin e rolit të tij, pra në digjitalizimin e procesit mësimor, i cili, hap pas hapi, të çon drejt një transformimi digjital të mirëfilltë të institucionit.

Por, që të realizohet në mënyrë efikase, ky proces kërkon një staf pedagogjik të hapur ndaj sugjerimeve dhe frymës së ndryshimit. Siç pohon mësuese Rudina, sfidat në këtë aspekt nuk mungojnë pasi, si në çdo kontekst, gjithnjë do të ketë individë më rezistentë ndaj iniciativave të tilla. Arsyet mund të jenë nga më të ndryshmet: aftësitë digjitale ende jo të konsoliduara, bindja në mjaftueshmërinë e metodave tradicionale,

hamendësimi mbi rritjen e volumit të punës përgatitore, pasiguria në suksesin e orës së mësimin mbi bazën e qasjeve të tilla, mungesa e motivimit apo ndonjëherë edhe vështirësia e pranimit të sugjerimeve dhe ndihmës nga një koleq.

Por mësuese Rudina, falë përvojës së pasur dhe qasjeve të përshtatura që aplikon me mësuesit, arrin t'i përballojë me sukses këto sfida. Sipas saj, impakti që ka mbështetja e ofruar nga Personi Kyç i Digjitalizimit, edhe pse ende në fillimet e nismës, i minimizon vështirësitë e hasura. Mësuesit, gradualisht, fitojnë më shumë besim në një shkëmbim të tillë horizontal. Nis të krijohet një mendësi bashkëkohore mbi edukimin në tërësi, teksa përfitimet nga digjitalizimi i procesit të mësimdhënies dhe të nxënies bëhen më të dukshme. Me kalimin e kohës, përvoja e mësuesve shtohet dhe paralelisht me të, edhe vetësiguria. Nxënësit, nga ana e tyre, nisin të pasqyrojnë efektet pozitive të modernizimit të procesit mësimor. Të gjitha këto ndikojnë edhe në motivimin e mëtejshëm të Personit Kyç të Digjitalizimit, duke krijuar një rreth virtuoz që sa vjen e konsolidohet.

Po ashtu, mësuese Rudina diskuton shpesh me kolegët e saj mbi nevojën për riformësim të rolit të mësuesit në mësimin e kombinuar, duke vënë theksin veçanërisht në rolet e mësuesve si instruktorë që garantojnë dhënien e udhëzimeve të qarta, sidomos në përdorimin e platformave në mënyrë të pavarur, por edhe si facilitues (lehtësues) përgjatë zhvillimit të veprimtarive online në orën e mësimin.

ORGANIZIMI I ORËVE TË HAPURA: NJË HAP MË TEJ NË PËRQAFIMIN E MËSIMIT TË KOMBINUAR

Që në krye të herës, mësuese Rudina e ka kuptuar se të mbash pozicionin e Personit Kyç të Digjitalizimit do të thotë të jesh edhe kreativ, duke ardhur vazhdimisht me ide të reja përballë kolegëve. Me vizionin e qartë të implementimit të strategjive të reja të mësimdhënies në nivel institucional, mësuesja ka menduar që hapi i radhës të jetë organizimi i një ore të hapur me pjesëmarrjen e mësuesve, me fokus aplikimin e mësimin të kombinuar. Gjatë një ore të tillë, e cila me siguri nuk do të jetë e vetmja, Rudina, në pozitë të mësueses dhe të Personit Kyç të Digjitalizimit, synon të promovojë mësimin e kombinuar, duke e ndërthurur njëkohësisht me mesazhe të qarta mbi kontributin që mund të japë si promovuese e digjitalizimit

Aftësimi digjital mes mësuesëve në mbështetje të përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie

Dorian Memoçi, shkolla “Teknike Ekonomike” Tiranë



Ndryshimet e shpejta teknologjike të dekadës së fundit kanë rritur nevojën e të rinjve të sotëm për të zotëruar një nivel të lartë aftësish digjiitale. Paralelisht me evolucionin teknologjik, kanë evoluuar edhe shprehitë e të nxënësve, kanë ndryshuar nevojat e nxënësve dhe konteksti në të cilën ata veprojnë, duke e bërë të pashmangshme përshtatjen e shkollave me rrethanat e reja, për të ofruar një përvojë arsimore gjithëpërfshirëse dhe të sigurt. Për të arritur këtë qëllim, është e domosdoshme që mësuesit nga ana e tyre të qëndrojnë të përditësuar dhe të aplikojnë forma të mësimdhënies ku në fokus qëndron zhvillimi i aftësive digjiitale dhe atyre për jetën. Duke vepruar kështu, mësuesit mund të sigurohen që po u ofrojnë nxënësve të tyre një zhvillim shumëdimensional, që i përgatit ata të jenë të suksesshëm në këtë epokë digjiitale. Kjo mendësi është shumë e rëndësishme për Dorian Memoçin, mësues i ri në moshë, pranë shkollës “Teknike Ekonomike” Tiranë. Brenda një kohe të shkurtër, me dëshirën dhe motivimin që e karakterizon, ai arriti të afrojë pranë vetes kolegët për të punuar së bashku drejt një qëllimi madhor, atë të modernizimit të procesit mësimor, ku kryefjala është integrimi efektiv i teknologjisë në metodat e mësimdhënies.

NEVOJA E AFTËSIMIT DIGJITAL TË MËSUESVE

Në shkollën “Teknike Ekonomike” Tiranë, të gjithë aktorët kanë përqafuar modernizimin në edukim. Përdorimi i teknologjisë në procesin mësimor është shndërruar në një element tërheqës dhe motivues për nxënësit, si në aspektin e të nxënësve, ashtu edhe jashtë kuadrit mësimor. Duke parë potencialin që integrimi i teknologjisë ka në klasë, mësuesit e kësaj shkolle aplikojnë prej disa vitesh metodat e ndryshme të mësimdhënies me bazë teknologjinë. Ky përqafim nuk ka qenë i menjëhershëm. Fillimisht, disa mësues kanë sjellë materiale mësimore në formën e një videoje. Disa të tjerë kanë realizuar kuicet online. Megjithatë ishte aksesimi në përmbajtjen mësimore digjiitale në platformën MësoVET i cili mundësoi integrimin e mirëfilltë të teknologjisë në procesin mësimor, me shumëllojshmërinë e alternativave dhe avantazheve që ajo sjell. Por përdorimi i teknologjisë në mënyrë efektive në klasë kërkon zotërimin e aftësive digjiitale të nevojshme për këto qasje novatore. Mësues Doriani, i cili ka marrë përsipër edhe rolin e Personit Kyç të Digjitalizimit, shprehet se të përvetësosh modelet e reja të mësimdhënies, ku aktivitetet ballë për ballë kombinohen me ato online, kërkon jo vetëm aftësi të mira digjiitale, por edhe njohuritë, shprehitë dhe qëndrimet e duhura që mundësojnë integrimin në mënyrë efektive të teknologjisë. Për këtë arsye, aftësimi digjital i mësuesve në shkollën “Teknike Ekonomike” Tiranë nuk shihet vetëm në kuadër të përdorimit të mjeteve dhe platformave të ndryshme digjiitale, por edhe në aftësinë

për të vlerësuar në mënyrë kritike dhe për të marrë vendime të informuara mbi format e mësimdhënies që do të përdoren në klasë, në bazë të nevojave specifike të nxënësve dhe temës së trajtuar. “Mësuesit me një shkallë të lartë kompetencash digjitalizimi mund të krijojnë përvoja dinamike dhe tërheqëse të të nxënësve, që nxitin kreativitetin, të menduarit kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve tek nxënësit.”

SI LEHTËSOHET AFTËSIMI DIGJITAL MES KOLEGËSH?

Identifikimi i nevojës për zhvillimin e kompetencave digjiitale ishte vetëm hapi i parë në rrugën e digjitalizimit të procesit mësimor në shkollën “Teknike Ekonomike” Tiranë. Një rol shumë të rëndësishëm luajti bashkëpunimi mes mësuesve të kësaj shkolle dhe mendësia e tyre për të qenë të hapur ndaj ndarjes së eksperiencave dhe të mësuarit nga njëri-tjetri. Duke qenë i sigurt në aftësitë e tij digjiitale dhe i përditësuar me teknologjitë e fundit, mësues Doriani iu besua zhvillimi i aftësive digjiitale të mësuesve, si dhe suporti në aspektet teknike të përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie. Duke punuar së bashku dhe duke motivuar njëri-tjetrin, mësuesit fituan njohuritë e duhura dhe besimin se janë të aftë të menaxhojnë dhe të integrojnë me sukses teknologjinë në orën mësimore.

Krijimi i një mjedisi bashkëpunues dhe mbështetës lehtësoi rolin që mori përsipër mësues Dori, rol i cili

tashmë është formalizuar nën emrin e Personit Kyç të Digjitalizimit. Ai tregon se mësuesit, ashtu si dhe vetë nxënësit, janë të larmishëm. Ata vijnë me eksperiencë dhe ekspertizë të ndryshme në fushën ku veprojnë, dikush prej shumë vitesh e dikush më pak. Tipologjia e mësuesve dallonte nga njëri te tjetri. Kishte mësues me eksperiencë në mësimdhënie, por me aftësi bazë digjitale, mësues me pak eksperiencë, por me aftësi digjitale të kënaqshme. Pra, një pjesë prej tyre e përqafonte më shpejt teknologjinë, ndërsa të tjerë shfaqeshin më rezistentë ndaj saj. Për këtë arsye, mësues Dorit iu desh të përshtatë qasjen që kishte ndaj secilit prej tyre. Me disa prej tyre ai punoi në grup, me disa të tjerë individualisht. Kishte mësues që motivoheshin për të zhvilluar aftësitë e tyre duke i mbështetur përgjatë orës mësimore, duke i treguar atyre në praktikë se si mund të përdoren teknologjia dhe se si mund të aplikohet ajo në klasën e tyre. Edhe pse i gjendur përballë vështirësive, mësues Dori tregon se ajo çfarë e shtyu të mos hiqte dorë nga ky pozicion, ishte këmbëngulja e mësuesve, të cilët, edhe nëse nuk ia dilnin plotësisht mbanë, vazhdonin t'i drejtoheshin mësuesit me dëshirën për të bërë më të mirën e tyre.

MBËSHTETJA E PERSONIT KYÇ TË DIGJITALIZIMIT

Sipas mësues Dorianit, të jesh në rolin e Personit Kyç të Digjitalizimit është një përgjegjësi jo e pakët. Nga njëra anë, duhet t'u gjendesh pranë mësuesve në momentet kur kanë nevojë për t'u asistuar në përdorimin e teknologjive digjitale, por nga ana tjetër duhet të përpiqesh edhe të deduktosh në tërësi mbi pikat e tyre të dobëta dhe të përcaktosh teknika e strategji për t'i adresuar ato. Por si u qaset konkretisht mësues Doriani kolegëve?

Një platformë, shumë përfitime

Të ndërjegjësohesh mbi avantazhet e ndërtimit të orëve mësimore të bazuara në përdorimin e teknologjive digjitale është hapi i parë drejt integritit të tyre në mësimdhënie. Për këtë, një prej mënyrave se si mësues Doriani e ofron suportin e tij ndaj kolegëve është duke i njohur ata, si në teori edhe në praktikë, me përfitimet e platformës digjitale MësoVET. Kolegët njihen kështu me lehtësitë dhe efikasitetin e disponimit të një mjedisi mësimor virtual të përbashkët, ku mësuesit mund të përdorin materiale mësimore digjitale ekzistuese, t'i përshtatin ato sipas kontekstit të tyre dhe preferencave të audiencës, të komunikojnë në çdo moment me nxënësit nga cilado pajisje, të administrojnë detyra e projekte lehtësisht të aksesueshme në çdo kohë, të realizojnë procesin e vlerësimit dhe të dhënies së

feedback-ut, si dhe të monitorojnë pjesëmarrjen dhe progresin e nxënësve. Një tjetër përfitim që artikullohet vazhdimisht nga mësues Doriani është edhe mënyra se si materialet mësimore digjitale mund të përdoren përgjatë orës së mësimi, si bazë për ndërtimin e një ore të kombinuar.

Pasurimi dhe përditësimi i materialeve mësimore digjitale

Një prej avantazheve kryesore të platformës MësoVET është mundësia për të përshtatur materialin mësimor digjital në hapësirën që i dedikohet lëndës së tyre. Secili mësues mund të realizojë ndërhyrjet e nevojshme në materialin ekzistues, në përputhje me mënyrën e organizimit të orës së mësimi, si dhe me nevojat dhe interesat e nxënësve. Njëkohësisht, mësuesit mund të editojnë lehtësisht përmbajtjen e materialeve për t'i përditësuar ato me të reja e fushës apo për të rifreskuar të dhëna të ndryshme. Kjo përfaqëson edhe një prej mbështetjeve kryesore që ofron mësues Doriani, duke i ndihmuar mësuesit të përdorin në mënyrë efikase funksionalitetet e platformës. Në këtë mënyrë, çdo mësues ka në dorë një material mësimor konform kurrikulës, por të kontekstualizuar.

Realizimi i procesit të vlerësimit nëpërmjet platformës

Impakti që krijoi te nxënësit vlerësimi online, shtyu të gjithë mësuesit e shkollës të aplikojnë një qasje të njëjtë në lëndën e tyre. Mësuesit e parë që e testuan, vunë re një motivim dhe angazhim më të lartë të nxënësve gjatë orës së mësimi. Paralelisht me vlerësimin e njohurive, nxënësit zhvillonin nëpërmjet kësaj qasjeje edhe aftësitë e tyre digjitale, në sajë të përdorimit të platformave të ndryshme për këtë qëllim. Për këto arsye, kolegët iu drejtuan mësues Dorianit për t'i mbështetur në zhvillimin në format digjital të provimeve vjetore apo semestrale, si dhe të ato të një grupi kapitujsh apo temash. Doriani mundohet të diversifikojë burimet e përdorura, ku herë aftëson mësuesit në përdorimin e Google Form, herë në përdorimin e platformave interaktive si Mentimeter e Kahoot dhe padyshim në testet që mund të realizohen në platformën MësoVET, të cilat janë lehtësisht të dokumentueshme dhe mund të përdoren edhe në vitet e ardhshme.

Organizimi i trajnimeve në grupe

Në rolin e Personit Kyç të Digjitalizimit, mësues Doriani e ka kuptuar shpejt se përforcimi i kompetencës digjitale në përgjithësi dhe aftësimi mbi platformën mësimore MësoVET në veçanti, nuk mund të realizohet vetëm duke mbështetur mësuesit në mënyrë individuale dhe spontane, në momentin kur mësuesi ka nevojë. Qasja duhet të realizohet edhe në grup, në mënyrë të strukturuar dhe të qëllimshme, duke përfituar edhe

nga mundësitë e ndërveprimit mes kolegëve. Me këtë ide, mësues Doriani organizon herë pas here trajnime të shkurtra në grup, gjatë të cilave i instrukturon kolegët mbi përdorimin e funksionaliteteve të ndryshme të platformës MësoVET, mbi mënyrën se si mund të zhvillojnë aktivitetet e përfshira në materialet mësimore digjitale, si dhe mbi opsionet e monitorimit dhe të raportimeve që mundëson platforma. Duke u praktikuar konkretisht në platformë, mësuesit diskutojnë së bashku mbi vështirësitë që hasin, si dhe mësojnë nga njohuritë dhe përvojat e njëri-tjetrit.



NGA MBËSHTETJA MES KOLEGËVE TE QËNDRUESHMËRIA

Të krijosh një sistem të tillë mbështetjeje mes kolegësh me qëllim konsolidimin e aftësive digjitale, nuk do të thotë të ngarkosh përgjithmonë më të aftin me detyrën për të asistuar ata që kanë më shumë nevojë të përmirësohen digjitalisht. Në bazë të nismës së funksionimit të Personit Kyç të Digjitalizimit nuk qëndron dorëzimi ndaj faktit se gjithnjë do të ketë kolegë që do të jenë disi më të ngadaltë apo rezistentë në përvetësimin e aftësive digjitale dhe në integrimin e teknologjisë në procesin mësimor. Thelbi qëndron te dhënia e disa impulseve fillestare, të cilat gradualisht, me rritjen e ndërgjegjësisë dhe të përvojës, do të përkthehen në siguri, duke bërë që çdo mësues të ecë i pavarur në rrugëtimin e tij drejt mësimdhënies digjitale. Me anë të kësaj qasjeje që premtan qëndrueshmëri, shumë shpejt përdorimi i teknologjisë dhe digjitalizimi do të shihen “prej natyre” pjesë të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PRAKTIKA TË MIRA TË DIGJITALIZIMIT NË MËSIMDHËNIE

RASTE TË MIRA 2023

LE TË MBETEMI NË KONTAKT!

 WWW.AFTESIPERPUNE.AL

 [@S4J.SWISSCONTACT](https://www.facebook.com/S4J.SWISSCONTACT)

 [AFTËSI PËR PUNË S4J](https://www.youtube.com/AFTESI_PËR_PUNË_S4J)

 [SKILLS_FOR_JOBS](https://www.instagram.com/SKILLS_FOR_JOBS)

 [SKILLS FOR JOBS ALBANIA](https://www.linkedin.com/company/SKILLS_FOR_JOBS_ALBANIA)